

# Dukagjini "Nderi i Kombit"



# Dukagjini

Botim Periodik i Shoqatës Atdhetare "Dukagjini", Viti i XVIII i botimit, nr. 214, Gusht 2021  
Nr. Llog. UNIONBANK 510367047020112, Shkodër - Albania, Tel. 00355692465784, internet: www.shoqatadukagjini.com, Kryeredaktore: Luigj Shyti, Çmimi 30 lekë / 1.5 euro

## Gjakmarrja<sup>2</sup> çështje nderi apo drejtësie?

Duke lexuar librin, me titull "Monolog me veten", të autorit Meritan Spahija, botuar nga shtëpia botuese "FIORENTIA", më 2018, të gjitha pjesët e tij më kanë tërhequr vëmendjen, si: "Poeti i përsosur...", "Për një Eco të papërsëritshme...", "Dimër i butë", "Gjamimet", "Valë në breg" e të tjerat, por në mënyrë të veçantë më tërhoqi vëmendjen pjesa "Çështje nderi". Këtë pjesë e kemi botuar në gazetën "Dukagjini", nr. 211, në qershor të këtij viti, për të tërhequr mendimin e lexuesve të gazetës "Dukagjini". **Çfarë është apo si konceptohet nderi?** Sipas fjalorit të Gjuhës Shqipe, viti 1980, në faqen 1204, shkruhet: Nderi - Tërësia e vetive a e tipareve morale të njeriut, që burojnë nga parime të caktuara, që çmohen nga shoqëria në çështjet e në veprimet e tij në rrugë të drejtë; cipa e njeriut në shoqëri ...

## KOLË PROGNI LA TRASHËGIMTAR MA TË MIRIN DJALË TË NIKAJ MERTURIT

Pavluë kazani i ditës së sotme zermçe kolegu dhe miku Kadri Fikaj më tha në telefon:

- Po pate kohe hajde e merre monografinë Nikaj Mërturi të Kolë Prognit. E dija se ishte në proces, shkova mora medëshirë dhe dhimbjepasi do t'ha dashur ta merrja nga dora e autorit<sup>8</sup>

## BEJTA SHKODRANE SHOW "Diaspora mes nesh"<sup>4</sup>

Pas kurorëzimit të bashkimit të Grupit "Bejta Shkodrane Show" me Shoqatën Kulturor Artistike "Jehona e Shkodrës", ky grup aktiv me regjisor Bujar Zurali për 16 vite e pa të arsyeshme që pas 16 vitesh të gjejë një shtëpi të re, ku dhe aktiviteti i tij të bëhet më evident dhe të jetë më i pranishëm në veprimtari që lidhen me trashëgiminë shkodrane, veçanërisht në zhanrin e improvizimit të bejtës shkodrane, e cila asnjëherë nuk është shkruar dhe thënë duke e menduar, por duke e krijuar dhe interpretuar.

Me një shikim të shpejtë, biramela prej natyre ata dijnë me vretë ambientin e me i kapë shpejt e shpejt tiparet karakteristike të secilit për t'i improvizuar në bejtë me lehtësi të madhe. Ata kërkojnë anët qesharake dhe i përshkruajnë në qetësi, duke i paraqitë të metat të zmadhuara ose të zvogluara si në karikaturë.

## PLISI DHE ARMA: KULTURA E MBAJTJES DHE E PËRDORIMIT NË TRADITËN SHQIPTARE<sup>10</sup>

Nga **Prend Buzhala**: Në të kaluarën plisi ka pasur vlerën e një formimi të brendshëm të sjelljes, t[ë] mënyrës së jetesës e të një rituali serioz. Edhe sot mbahen kapela të ndryshme: serioze e joserioze, ushtarake e policore, kësula të infermierëve apo të punëtorëve të ndërtimtarisë. Shohim kapelat e ritualit akademik apo të studentëve të diplomuar, ato të klerikëve apo ato të pilotëve. Secila prej tyre ka kanë mënyrën e vet të përdorimit dhe ritin e përdorimit. Kapela është tregues i një profesioni serioz, por ajo shënjon edhe shumëçka tjetër. Kur hiqet kapela, e kuptojmë se ai njeri e ka kryer shërbimin. Kur hiqet me një dorë, dhe personi përulet, ajo është shenjë nderimi ...

## Udhëtimi Theth- Valbonë, një aventurë e këndshme<sup>6</sup>

### Prolog-ekspoze përshkruese

Mbase për shumëkënd, ky titull çalon pak, por për moshatarët e mi, që janë pothuajse në mesin e dekadës së tetë, mendoj se nuk ka të sharë. Këto dy qendra, ndër më të banuarat e të vizituarat, janë e mbeten synimi i çdo vizitori, pa harruar se Alpet e Shqipërisë, akoma të pastudiara sa duhet, kudo kanë bukuri marramendëse që befasojnë, klimë të shëndetshme e shumë burime ujë. Popullimi, veçanërisht kur natyra vesh petkun e blertë, është i konsiderueshëm, lëvizjet e komunikimet e ...





# Gjakmarrja

## çështje nderi apo drejtësie?

Duke lexuar librin, me titull “Monolog me veten”, të autorit Meritan Spahija, botuar nga shtëpia botuese “FIORINTIA”, më 2018, të gjitha pjesët e tij më kanë tërhequr vëmendjen, si: “Poeti i përsosur...”, “Për një Eco të papërsëritshme...”, “Dimër i butë”, “Gjamimet”, “Valë në breg” e të tjerat, por në mënyrë të veçantë më tërhoqi vëmendjen pjesa “Çështje nderi”. Këtë pjesë e kemi botuar në gazetën “Dukagjini”, nr. 211, në qershor të këtij viti, për të tërhequr mendimin e lexuesve të gazetës “Dukagjini”.

### Çfarë është apo si konceptohet nderi?

Sipas fjalorit të Gjuhës Shqipe, viti 1980, në faqen 1204, shkruhet: Nderi - Tërësia e vetive a e tipareve morale të njeriut, që burojnë nga parime të caktuara, që çmohen nga shoqëria në çështjet e në veprimet e tij në rrugë të drejtë; cipa e njeriut në shoqëri ...

\* Nderi i familjes ... \* Çështje nderi ...

\* Rruga e nderit ...

Duke u nisur nga kjo, çfarë mund të themi për luftën e zhvilluar në Trojë, që njihet me “Lufta e Trojës”, a ishte çështje nderi apo çështje ekspansioni? A ishte një rast që u erdhi e që e shfrytëzuan, se mbase edhe mund ta kishin pasur në plan: u erdhi dhe e shfrytëzuan?

Monologu “Çështje nderi”, është një material mjaft interesant, shkruar me kompetencë, çka tregon se autori e ka studiuar me shumë pasion legjendën e famshme të Trojës, duke shkruar edhe për aspekte të treja të saj, të panjohura nga lexuesi i thjeshtë i veprës së Homerit, apo shikuesi i pasionuar i filmit artistik, në tre variante të historisë në fjalë: “Helena e Trojës”, “Kali i Trojës” dhe “Troja”, - thekson studiuesi e publicisti Gjon Bruçi.

Ai shkruan: “Ajo luftë ishte thjeshtë çështje nderi. Jo tjetër”. Më tej vijon: “Ky qytetërim, i lindur nga gjenialiteti, është i gatshëm të shuhet nga marrëzia. Për ta, nderi është më i rëndësishëm se demokracia, lufta absurde më e rëndësishme se bujqësia dhe lavdia në betejë më e rëndësishme se jeta. Në kokat e këtyre njerëzve është në të njëjtin nivel, si urtësia gjeniale, si marrëzia”.

Pra, duke u nisur nga këto të dy të veçanta të shkruara, mendova të jap mendimin tim, duke u ndalur, jo vetëm për përcaktimet e të drejtës dokesore, kush quhet “shkelje nderi”, por dhe për gjakmarrjen, e cila është “çështje nderi” apo thjeshtë një barazim “më vrave - do të vras”, një vetëdrejtësi?

Librin e tete të Kanunit të “Leke Dukagjini”, në faqe 65, theksohet NDERA, dhe në këtë pjesë, po ndalemi te NDERA VETJAKE (vehtjake në tekst). Në nenin 597, theksohet: “Ndera e marrun gjobë

nuk ka”, “Nderasi dhe e marrun s’falet kurrë”. Më poshtë, në nenin 598, shpjegohet më qarte: “Ndera e marrun nuk shpërblehet me gjë, por a me të derdhun të gjakut, a me të falun fisnikisht (përmbas ndërmjetësisë së dashamirëve). Por, në nenin 600 theksohet: “Ai, të cillit iu muer ndera, xehet i dekun kah kanuja”. Këto dy nene duket sikur na ofrojnë një kundrlthënie e, siç thonë populli, “hip në peme të vrava, zbrit në toke të vrava”. Kështu, ai që është i fyer, nuk e din ku të rrijë dhe si të veprojë. Fyerja apo marrja e nderit nuk falet, por po vrave mbetë në gjak. Në nenin 601, që titullohet “Ndera i mirret burrit”, ku rradihen njëmbëdhjetë raste të shnderimit të burrit, të cilat janë:

- Me i thanë se rren faqe burrave të mbledhun në kuvend;
- Me e pshty, me i u matë, me e shty a me i ra kush;
- Me i prishë ndermjetsin a besën;
- Me i a dhunue gruan a me ia hikun;
- Me i a marrue armët e krahit a të brezit;
- Me i a dhunue bukën, tuj e a nga mikun a punëtorin;
- Me i a thy shpin, vathin, kotecin a çarranikun n’ oborr;
- Me i a ndalë uhan e detyrën;
- Me i a lujetë rrasen e vegshit në voter;
- Me njeje kashaten për para mikut - i merret ndera mikut;
- Me koritë trevezen ndër sy të mikut, kur i zoti i shpis e kruen fulteren a shin e lëpin kupen.

\*\*\*

Duke e quajtur Luftën e Trojës “çështje nderi”, dhe mirë e quan autori ashtu, fyerja që e ka shkaktuar atë është e lidhur me pikën “d”, në të cilën theksohet: “Me i a dhunue gruan a me ia hikun”. Sipas këtij paragrafi, Menelau ka arsye të plotë për të luftuar për nder, sepse Paridi i Trojës, nuk e ka fyer vetëm duke “ia prekur” gruan, por gjithashtu e ka rrëmbyer, “ia ka hjekun” pra, ia ka marrë Helenën. Prandaj, ai ka të drejtën e vënies së nderit në vend, çka nxiti një luftë, pasojat e së cilës i dimë të gjithë: një Troje e shkatërruar dhe e djegur plotësisht, pa llogaritur humbjet në njerëz. Duke u nisur nga ky arsyetim, autori thekson: “Ajo luftë ishte thjeshtë çështje nderi. Jo tjetër.”

Po shkruaj një ndodhi krejt të thjeshtë, por që ka të bëjë me nderin, me germën “k”, që shkruhet: “Me koritë trevezen nder sy të mikut, kur i zoti i shpis e kruen fulteren, a shin e lpin kupen”. Ka qenë traditë,



që mikut, në fund të bukës, t’i vendoset përpara një fultere me t’lyen të shkrirë dhe, sigurisht, miku do të ngjyente një apo dy kafshatë dhe i rriste nderën shtëpiakut për mikpritjen. Mundet dhe shpijaku të ngjyente një apo dy kafshate, apo, si i thonë, pak më shumë se miku, por në asnjë mënyrë të fshinte fulteren, se ishte fyerje për mikun, në kuptimin se, pjesëtarët e familjes nuk e dinin se kush e fshiu fulteren. Do të mendonin se e ka fshirë miku dhe, dashje a pa dashje, ai do të ndjehej i fyer, ngaqë do të konsiderohej si hamës, a llupës.

Kështu, shkon miku në një familje. U prit me shumë mall e dashuri, me të tanë të mirat, pinë e hëngrën. Në fund sjellin në treveze një fultere me t’lyen të shkrirë. Miku, megjithëse ishte i ngopur, në respekt, ngjeu një kafshatë bukë dhe falënderon shpijakun për pritjen. Por shpijaku nuk ndalet dhe e fshinë plotësisht fulteren. Miku, i fyer rendë dhe me çue nderin në vend, pasi duhej ta merrni vesh të gjithë se ai nuk e fshiu fulteren, por shpijaku, kapi për bishti fulteren dhe ia dha për krye shpijakut. U bë zhurmë e madhe. Nuk kish ndodhë ndonjëherë një gjë e tillë. U mblodhën fqinjë e pleqnarë, për t’u njohur me ketë ngjarje dhe për ta gjykuar. Për këtë pyeten mikun:

- Pse i re fultere krese shpijakut?

Ai, pasi u a shpjegoi pritjen e shpijakut dhe momentin e fulteres me t’lyen, u tha:

- Nuk kisha mënyrë tjetër për t’u treguar pjesëtarëve të familjes, grave e fëmijëve, se fulteren nuk e fshiva unë, por e fshiu shpijaku i juaj. Kështu, të turpërohet ai, jo unë ...

Miku doli i lare dhe i fyer mbeti miku.

Pra, deri në këto imtësi të tilla,

në qoftë se do t’i quajmë kështu, ishin përcaktuar rregullat apo normat në të drejtën dokesore, të cilat vinin nga lashtësia e hershme, mijëra vjeçare. Pra, gjithçka ishte e përcaktuar dhe zbatoheshin me korrektësinë më të madhe. Në të kundër, prishej rregullsia, çënohej e drejta dokesore dhe pastaj do të ishte pasojta.

Akademiku Rexhep Qosja për nderin shkruan: “Ç’është nderi! Ç’është nderi kur duhet të vdesësh! Një fjalë e marrë, por e madhe! Ngushëllim i vogël para fundit të paskaj. Njerëzit e mendshëm janë fatkëqinj se të tjerët ndjehen të vegjël skaj tyre. E vogëlsia e ka xhelozinë e madhe dhe urrejtjen e pazgjedhur. Le të bëhet i fortë dhe i pamëshirshëm se me mëshirën nuk mbërrin askund, s’ia del me askënd, s’fiton asgjë. Nuk është kjo kohë e mëshirës dhe e dashurisë. Kjo është kohë e sundimit të dhunës. Me të i çel dyert, që s’i çel mendja dhe i shtrin poshtë grushtet e urrejtjes. Nuk ka tjetër ligj. Mëshira është harruar kur në dorë janë marrë mburoja, shigjeta dhe shpata. Me të përcjellim vetëm të vdekurit”. (Botuar në gazetën “DITA”, me datë 25 qershor 2021)

Akademiku është i madh si mendimtar, i ditur dhe udhërrëfyes, por pavarësisht ngjarjeve jo të pakta, të djeshme dhe të sotme, ato nuk duhet të përgjithësohen e të bëhen problematike, se njerëzia shkon drejt një emancipimi të plotë, që çdo gjë do të zgjidhet në bazë të ligjit dhe jo mbi bazën e së drejtës dokesore.

Gjithsesi, shkojmë në kohën që bën monolog miku i jone, shkrimtari e përkthyesi Meritan Spahija. “Madje, madje, për një fyerje edhe më të vogël, nuk do ta kishte aspak të vështirë që, çdonjërin me të cilin po rrinë, ta stojnë në duel. Edhe se kanë pirë disa dhjetëra kupa verë së bashku... Kjo s’është aspak e rëndësishme! Veç nderi, ah, po! Veç nderi! Çfarë ironie: këto nderëtarë, burra me mustakë e me mjekër të zezë, nuk besojnë aspak në një histori pastërtisht nderi, në një histori që mund të ishte e tyrja; në një histori që, po të kishin jetuar në atë kohë dhe t’i kishin ftuar të merrnin pjesë aty, pavarësisht se në cilin krah, mjafton të bëje pjesë në një çështje nderi, do të sakrifikonin po ashtu si ata, po aq lehtë si ata, ata të hershmit, të cilët këta i quajnë Etnit”.

Pra, NDERI ishte mbi gjithçka. Ai ishte barometri i matjes se sa vlere kishte njeri apo tjetri, pavarësisht pozitive. Edhe sot, megjithëse me një barre shkollë, me tituj të ndryshëm shkencore, personalitete publike dhe deri edhe ata që e konsiderojnë veten lider, jo në pak



raste fyejnë dhe sipas mendësisë së tyre primitive, duhet marre shpata. Këta nuk e kane aftësinë për të diskutuar në publik dhe për rrjedhojë nuk kane guxim qytetar për të kërkuar falje publike ashtu siç fyen publikisht. Pse? Se, ne ende vijojmë të jemi primitive në mendësi, të sajohet e të tregohemi më të forte, më të zot e të tjera, mendësi këto që nuk të lanë të ecim përpara. Prandaj, me të drejte Meritani shkruan: “Ky qytetërim, i lindur nga gjenialiteti, është i gatshëm të shuhet nga marrëzia. Për ta, nderi është më i rëndësishëm se demokracia, lufta absurde më e rëndësishme se bujqësia dhe lavdia në beteja më e rëndësishme se jeta. Në kokat e këtyre njerëzve është në të njëjtin nivel, si urtësia gjeniale, si marrëzia”.

Në nenin 597, te Kanunit te “Leke Dukagjini”, theksohet: “Ndera e marrun, gjobë nuk ka”. – Ndera e marrun, s’falet kurrë”.

Pse? Meritani bën këtë monolog: “Burrri për nder jeton! Edhe se do të hezitohet, sepse thellë brenda tyre e dinë se trojanët ishin vëllezërit tyre, dardanët të veriut, zbritur më në jug se ata, do të thonë me zë jo kumbues: - Dami lahet me gjak! Shkurt, nëse ndonjërit prej tyre do t’i thuhej se vëllau tij ka zhvendosur gardhin e arës vetëm një këmbë, do të ishte gati të luftonte me të, edhe se krejt arën do t’ia falte me bujari, pa ia kërkuar madje. Për ta nuk është e rëndësishme pasoja, por nderi; për ta është më e rëndësishme t’i respektojë vëllai se vetë vëllai; për ta dëmi nuk qëndron tek një këmbë arë, por tek shpërfillja. Për mungesë respekti të vrasin, për të kundërtën nuk dinë si të shpërblejnë. Jetojnë mes skajeve, pa njohur të mesmen”.

Gjoni, mbështetur në këtë monolog, në mes të tjerave shkruan: “Madje, për fat të keq, edhe sot në shekullin e njëzet e një, shqiptari mund të vritet për një ngacmim gardhi, për një vije uji të ndalur, qoftë dhe pa dashje, ndonëse një copë gardh nuk mund të jetë kurrë arsye për t’u vrarë, por mbi të qëndron nurrnia, nderi”.

Beso, se është e qarte, ashtu si bën monolog me veten Meritani në gjithë librin, por në veçanti në pjesën “Çështje nderi”. Pra, ajo luftë, dhe jo në pak raste dhe në ditët e sodit, me fqinjë e deri me vellanë, me këtë mendësi fatkeqësisht ecet. Urojmë që brezat e ardhshëm të emancipohen, të largohen nga këto mendësi primitive, duke njohur demokracinë, që do të thotë LIGJ!

\*\*\*

Më sipër, duke u udhëhequr nga ky monolog, kam shënuar titullin “Gjakmarrja është çështje nderi apo çështje drejtësie?!”

Mendoje, se janë te dyja bashke! Por unë dua të ndalem në dy drejtime:

Së pari, vërtetë, se pushka nuk fyen kënd, nuk korite kënd, siç theksohet në popull. Për këtë po tregoj një ndodhi: “Rreth vitit 1991, mora pjese në një mort, i kishin vra djalin, dhe disa muaj më pare, i kishin vra vëllain me gjithë bashkëshorten (kunatën e shpijakut). Shpijaku, nuk po munde të bisedonte me pjesëmarrësit në ngushëllim. Në këto momente tepër të dhimbshme, një burrë i vjetër, i drejtohet

shpijakut: “Qëndroni ..., se plumbi e derzhava (qeveria) nuk korisin kand!”. Ishte hera e pare që e dëgjova një shprehje të tillë ngushëlluese, në një rast të tillë kaq të dhimbshme. Kjo nuk ndodhet në të drejtën dokesore, por jeta i ka formuar dhe kane gjetuar shprehje të tilla goditëse aq sa i kane bërë pjese të jetës, për të gjetur forcën për të përballuar dhimbjen.

Sipas fjalorit të Gjuhës Shqipe, viti 1980, në faqen 596, shkruhet: Gjak-u-qeqet ... “Armiqësi, që shkaktohej ndërmjet familjeve a fiseve për shkak të një vrasjeje dhe që kërkonte të vritej një tjetër për të marre hakun e të vrarit ... hakmarrje, gjakmarrje, hasmëri ...”.

Pra, gjakmarrja është çështje Nderi. Nuk ka fyerje më të madhe, se sa t’i marrësh jetën tjetrit dhe ky dëm duhet barazuar. Prandaj i thonë gjaku shkon për gisht. Ja sa bukur është përcaktuar kjo çështje kaq delikate në të drejtën dokesore, në nenin 886 e deri në nenin 897, që theksohet vlerësimet si ndërmjet meshkujve, burrave dhe ndërmjet burrave e grave: “Çmimi i jetës së njerit asht një, si për të mirin si edhe për të keqin”. “Secilli



mbahet i mirë edhe i thotë vedit: “Jam burrë” e i thonë: “A je burrë!”. “Me kenë veçim gjaqesh, kanuja nuk kishte diejt me ia gjetë vangun punës prej pleqnish e pegjesh në peshim të të mirit e të keqit, tuj kenë se seicilli mbahet rrumbull katërqind derhem n’okë të vet”. “Me pasë lanë shtegun e veçimit të gjaqevet, të keqin per dukë e per fisniki-firukun-kishin me e vra edhe pa punë; ishin shtue vrasët, ‘si mos të kishte dalë kush me lypë arsye për vrasë të të keqit e të firukut”.

Prandaj marrja e gjakut ishte çështje nderi, pavarësisht se, si është veprua dhe jo në pak raste po veprohet dhe sot, është tjetër gjë, duke kaluar deri në anarki. E theksoj këtë, se ne baze të drejtës dokesore, sipas nenit 896 “Të rami në gjak, po u ba vrasa në katund, dorënsi me mashkullin të shpis, edhe ferishte djepi në kjoftë, do të bahen e do të dalin prej katundit e do të shkojnë nder miq, per me i u shmangë rrezikut të vrasës”, dhe quhej gjaku i marrun, nderi u vu në vend.

Gjakmarrja është dhe çështje drejtësie. Unë humba një mashkull, babain, vëllain, djalin apo kushëririn, dhe do të ve drejtësinë në vend, do të vras një mashkull të dorasit. Prandaj, në nenin 900 shkruhet: “Kanuja vonshme pershin mashkullimin e shpis së dorërasit mje në ferishte djepi;

kushrinin e nipat e ngiate, edhe se të damë, por per 24 orë, në valë të gjakut; e mbas 24 orësh do t’u qitte dorzanë shpija e të vramit”. Kjo është çështje drejtësie, sigurisht në baze të së drejtës dokesore.

Së dyti, dua të ndalem në një problem jo pak të vogël, të mendësive primitive, që ngritën krye pas vitit 1990. Me fillimet e proceseve demokratike, ngriti krye zbatimin i drejtës dokesore, me mendësinë: “Shteti i dobët, ngre krye e drejta dokesore!” Për rrjedhojë u miratuan Shoqata të pajtimit të gjaqeve, në kundërshtim me realitetin, kur ekzistonte shteti, Kushtetuta e ligjet përkatëse. Madje arritën të ngrënë krye mendësi të gabuar, duke u nisur nga pajtimi i gjaqeve në Kosovë dhe duke mos marre parasysh aspak gjendjen aktuale, që ishte krejt ndryshe në Kosovë dhe ndryshe në Republikën e Shqipërisë. Në Kosovë, ishte pushtuesi Serb, prej një shekulli; ndërsa republika e Shqipërisë nuk ishte e pushtuar. Madje në Shqipëri, shtresa e persekutuar nuk u ngrit të hakmerret ndaj persekutatoreve. Në gjithë Qarkun e Shkodrës ka pasur vetëm një vrasje. Nuk them, nëse këto shoqata u

por morën pjese. Madje morën dhe detyra nga këto “Kongrese”, të ndikojnë te strukturat e shtetit dhe te medias, që të zërthejnë Kanunin e të ndikojnë në zbatimin e tij. Arritën t’i bëjnë thirrje OKB-së, BE-së e SHBA-së, që të ndikojnë në vendosjen e rregullit përkundër gjakmarrjes. Arritën të shpërfitojnë realitetin, duke dhënë shifra të paqene, me qindra e deri me mijëra fëmije të ngjuar, deri me qindra gra të ngjuara, deri me qindra familje të ngjuara! Pse? Sepse në këtë mes u fut paraja.

U arrit që Presidenti të thotë: “E ndjeva veten mirë, kur mora pjese në pajtimin e dy familjeve!”, Presidenti të thotë: “Fëmijët e ngjuar duhet të shkojnë në shkollë!”. Një President priti në takim përfaqësuesit e një organizate, e cila kishte në mision të saj “Zgjidhjen e konflikteve ndëretnike”. Ne nuk kishin konflikte etnike dhe megjithatë vjen në Shqipëri, për të luftuar “gjakmarrjen...” dhe askush nuk i thotë, ktheu nga jeni nisur ...

Nuk besoj, se këta shpreheshin me qellim të caktuar, por shpreheshin, se vete janë me mendësi primitive, fisnore dhe i shërbenin shtetit të së drejtës dokesore dhe jo shtetit ligjor, demokracisë.

Beso, se arrita diçka të paraqes shqetësimin tim duke u ballafaquar me shkrimin e zotit Meritan Spahija, të titulluar “Çështje Nderi” dhe të shpreh konceptin se Gjakmarrja është çështje nderi apo çështje drejtësie?! Në të njëjtën kohë të paraqes dhe shqetësimin e ndjenjës primitive të mendësisë dhe pse jemi në demokraci, në shtetin e së drejtës ligjore, të disa strukturave të shtetit dhe deri te institucioni më i lartë i shtetit, Presidenti i Republikës së Shqipërisë!

Mbyllja:

Meritani shkruan: “Kështu, pas aq e aq shekujsh, pas një konsumimi thujse total të rendit të vlerave që i përcakton një kohë e dhënë, ai kod për ta nuk shërbente më si rregullator, por si mjet irracional vetëvrasjeje kolektive. Oh, të shkretët! Si duket, kur ua kanë mësuar atë, s’ua thanë të plotë. Nuk u kanë treguar se, më i rëndësishëm se ndëshkimi, është të kuptuarit e dëmit, çka përcakton edhe nivelin e faljes, a siç i thuhet sot, tolerancën. Toleranca, është përpjekja për të mirëkuptuar, a së paku kuptuar rrethanat, në të cilat shkaktohet një dëm, qëndron në themelin e çdo ndryshimi, qoftë edhe të kodit, qoftë ky edhe nderi, madje dhe i lashtë. Sikur t’ua kishin mëkuar këtë, do ishte ndryshe. Mbase ajo luftë absurde edhe mund të mos zhvillohej fare... Por lufta u bë. Për çështje nderi! Një luftë që shfarosi një rën palë dhe nga ku tjetra, fituesja, doli e përgjysmuar. Më e keqja: u vranë, u gjymtuan, u shfarosën pa u urryer. Fanatikë të një mendësie të dështuar, të një nderi, i cili dëmton të gjitha palët e s’i duhej më askujt”. Po ai kod, kodi i NDERIT, jetoi gjatë, por fatëkeqësisht vijon dhe në ditët e sotme, në ditët e shekullit XXI dhe që jo pak jetë njerëzish janë marrë, krejtësisht të pafajshëm.

Pres nga lexuesi, me kënaqësi mendime ndryshe, se vetëm do të kështu arrijmë të plotësojmë kuadrin e plote të formimit.

Ndue Sanaj



# Në Memorialin e dëshmorëve të Moksetit, mungojnë pesë dukagjinas

Isha i ftuar nëpërvizimin e këtij memoriali para të cilit përkulem me mirënjohjen dhe nderimin më të thellë. Fatosat e atdheut janë apostuj më sublim të një kombi. Një popull pa fatosa gjakfljuar nuk është asgjë tjetërveç një kopefatkeqe. Vetëm në një vend mjeran ku heroit dergjen pa varremund të kujtohet 110 vjet me vonesë përgardënvjet martirë, të vetëvararë nga harresa kolektive. Më mirë vonë se kurrë, ndaj gjithkush kontribuoi ju rritëndera përkëtimirësi të munguar dhe domosdoshmërishtë dobishme. Që pa u zbuluar pllakati kam pare e dëgjuar kundërshtinë rjetet sociale për pa saktësi në lidhje me listën martire. Kush punonedhe gabon! Porai që nuk punon as gjë dhe kritikon në mënyrë cinike nuk bën gabim, por faj. Gjithsesinë lapidarin e sapo nusëruar mungojnë 5 dukagjinas:

1. Bush Delia nga fshati Pylaj, krahinë e Shoshit, përveç folklorit i konfirmuar nga okulari At Kamiljo Libardi “Lëvizjet e para patriotike 1910-1911 dhe 1912;
2. Prekë Gjoni nga lagja Kasneci fshatit Kir;
3. Prekë Marashinga lagja Kasnec i fshatit Kir;
4. Lekë Ndounga lagje Aliaj i fshatit Kir;
5. Gjelosh Ujkanga fshati Megullë.

Në fushë betejën e Moksetit janë pla-

gosur Gjelosh Kola dhe Pjeter Ndou i fshatit Kir, si dhe Ndokë Martini i lagjes Boks (dëshmitare të intervistuar ne vitet 80-të nga Zef Zeka, autor i librit “NJE SHEKULL PER PULTIN”, Shkodër 2011, fq. 16-17.


Nuk dyshoj për kurrfarë qëndrim të qëllimshëm, por gabimi është i dukshëm dhe i pa pranueshëm nëse nuk korrektohet. Organizatorët dhe Shoqata Atdhetare “Dukagjini” pa hatër-mbetje duhet ta bëjnë këtë korigjimin sa më pare, përndryshe lapidari ngelet kaçul dukesh trembëruar kolonate një binomi historik shekullor. Kjo vikamëshun-

gullueselirëqë vepërë përbashkët e dybigave Malësi e Madhe dhe Dukagjin, të cilatu lanë krejt vetëm në këtë përpjekje që i tregoi Evropës se shqiptaret nuk do jetojnë kurrë më në ombrellën otomane.

Jam ndier për herë i mirëvlerësuar nga miq shokë e koleg në dhjetërave primtarinë Malësinë e Madhe, por nuk jam ndier aspak mirë me date 16. 08. 2021, kur as kush nuk foli një fjalë të vetme për ndihmëtarin historik Dukagjin. Historia është mësuese e madhe, prandaj që të mos gabojmë duhet te jemi nxënës të mirë të saj. Bashkia Malësi e Madhe, Shoqata Atdhetare “Dukagjini” dhe

Shoqata Atdhetare “Malësia e Madhe”, duhet përgatitë dokumentacionidhe kërkuar strukturave, për shpalljen dëshmorë të atdheut gjithë atyre që u flijuan në Moksetin e vitit 1911. Ka një shekull e një dekadë që kanë shkruar emrin në panteonin më lartë të kujtesës kombëtare, por është e turpshme për ne, që nuk i njohim dhe i vlerësojmë siç e meritojnë fatosat që nuk vdesin.

## Prele Milani



**Shënim:** Njoftojmë lexuesin e gazetës “Dukagjini”, se të renët dukagjinas, në Luftën për Liri e Pavarësi, kundër pushtuesit Otoman, në kuadrin e 100 vjetorit të Shpalljes së Pavarësisë, Kryesia e Shoqatës Atdhetare “Dukagjini” i ka propozuar për t’ju dhënë Statusin e Dëshmorit të Atdheut, me nr. 927, me datë 11 tetor 2012. Gjithashtu janë ripropozuar dhe me nr. 1427, datë 29 tetor 2020. Por deri tani, në as në njerin rast, nuk janë marrë në diskutim nga Këshilli i Bashkisë Shkodër.



# BEJTA SHKODRANE SHOW

## “Diaspora mes nesh”

Pas kurorëzimit të bashkimit të Grupit “Bejta Shkodrane Show” me Shoqatën Kulturore Artistike “Jehona e Shkodrës”, ky grup aktiv me regjisor Bujar Zurali për 16 vite e pa të arsyeshme që pas 16 vitesh të gjejë një shtëpi të re, ku dhe aktiviteti i tij të bëhet më evident dhe të jetë më i pranishëm në veprimtari që lidhen me trashëgiminë shkodrane, veçanërisht në zhanrin e improvizimit të bejtës shkodrane, e cila asnjëherë nuk është shkruar dhe thënë duke e menduar, por duke e krijuar dhe interpretuar.

Me një shikim të shpejtë, biramela prej natyre ata dijnë me vretë ambientin e me i kapë shpejt e shpejt tiparet karakteristike të secilit për t’i improvizuar në bejtë me lehtësi të madhe. Ata kërkojnë anët qesharake dhe i përshkruajnë në qetësi, duke i paraqitë të metat të zmadhuara ose të zvogluara si në karikaturë.

Mbrendia e bejteve është mjaft e larmishme: përmbajnë thërime përvojash, gjykime morale, përshtypje dhe mendime rreth ndonjë problemi për t’u zgjidhë. Kryesisht përmbajnë tallje tipash dhe individësh.

Mendoj se edhe Shoqata “Jehona e Shkodrës” kishte nevojë për këtë grup, por edhe ky grup kishte nevojë për këtë platformë kaq prestigjioze, siç është kjo shoqatë me producent Xhelal Halili.

Ky bashkim kaq i natyrshëm dhe artistik po tregon më së miri se ishte i duhuri, gjë që tregon ecurinë e sukseshme të “Bejtës Shkodrane”, ashtu siç ndodhi në spektaklin “Diaspora mes nesh” me këngë, bejta e humor në “Oborrin Shkodran”.

Në jetën e përditshme të qytetit të Shkodrës, bejta shkodrane dhe kënga

popullore janë gjithmonë të pranishme, si një ushqim shpirtëror e frymëzues, sepse kënga dhe humori janë pjesë e pandashme e banorëve të këtij qyteti.

Organizohen çdo vit koncerte, spektakle, sofrat me këngë dhe humor, por të gjitha në performancat e tyre kanë një bazë tradicionale që, në kulturën shpirtërore njihet si “Bejta Shkodrane”.

Për ta mbajtur të gjallë këtë traditë, për të mbajtur në formë bejtaxhijtë që tradita e vjetër të mbetet e gjallë, autentike, por edhe e freskuar me interpretues të rinj që janë pikërisht ata sot përfaqësues të këtij burimi të pashtershëm, “Bejta Shkodrane” me drejtuesin e saj Bujar Zurali në bashkëpunim me Agjensinë e spektakleve “Jehona e Shkodrës”, me producent Xhelal Halili, në “Oborrin Shkodran” zhvilluan një koncert artistik me pjesëmarrjen e bejtaxhijve dhe këngëtarëve shkodranë.

Në këtë spektakël morën pjesë humor-

istët Muhamet Çekini, Bujar Ademovi dhe Nexho Shabani, si dhe bejtaxhitë: Dilaver Cufi, Dila Mataj, Luigj Fierza, Qemal Sukniqi dhe Isuf Çoku. Gjithashtu pjesë e këtij spektakli ishin edhe këngëtarët: Eduart Jubani, Adnan Bala, Agim Molla dhe këngëtarja nga Gjakova Benita Pula, të shoqëruar nga instrumentistët Miri Zurali në tastierë, Elvin Unaza klarinet-saks dhe Izet Halili në violinë.

Moderatore e këtij spektakli ishte e mrekullueshmja Ketlin Pjalmi, Producent Xhelal Halili, regjisor Bujar Zurali. Media partner televizioni Star Plus.

Organizatorët jo më kot zgjodhën “Oborrin Shkodran” për ta kthyer në një skenë interpretimi tradicional, i cili që në pamjen e parë të krijonte idenë se po përjetoje këtë koncert si 100 vjet më parë.

Këta imazhe, si në një pikturë, i bënte më të pranishme rekuizita e kërkuar me fanatizëm për veshjen e këngëtarëve,

valltarëve dhe formacioneve.

“Bejta Shkodrane” pushtoi në këtë mbrëmje këtë oborr shkodran, duke rikthyer traditën e bukur të këtij qyteti të shquar të artit dhe të kulturës, duke improvizuar live disa nga bejtat më të bukura të kësaj tradite.

Ky oborr ishte mbushur si rrallë herë, siç mbushet një bahçe me lule të bukura në pranverë. E veçantë dhe pozitive ishte se përveç dashamirësve të moshuar, freski i jepte audiencës mosha e re e spektatorëve, djem e vajza shkodrane që shpesh pa të drejtë “akuzohen” se rendin pas muzikës moderne dhe harrojnë se qyteti i tyre ka bejta dhe këngë shumë të bukura.

Programin e prezantoi moderatoria Ketlin Pjalmi dhe që në prezantimin e saj të parë u përcollën emocione që spektatorët e pranishëm kishin kohë pa i shijuar. Ishin këto vlera të interpretuar live dhe me mjeshtri, me zëra të mrekullueshëm të artistëve shkodranë e kombinuar me bejtat dhe veshjet tradicionale të qytetit.

Çfarë vlere do të kishte nëse këtë pasuri nuk ja transmetojmë brezit të ri, për ta mbajtur përsëri të gjallë dhe pronë të qytetit këtë visar si një aromë e këndshme dhe e freskët në këtë oborr tradicional shkodran të kthyer në një skenë madhështore.

Për këtë aktivitet kaq emocionues, por edhe të rëndësishëm të qytetit të Shkodrës, organizatorët thanë se synimi është që të ruhet kjo traditë e bukur dhe të pasurohet më tej për t’ja çuar brezave të rinj të pastër dhe origjinale “Bejten Shkodrane”.

Ramazan Çeka,  
Gusht 2021





# Udhëtimi Theth-Valbonë, një aventurë e këndshme

## Prolog-ekspeze përshkruese

Mbase për shumëkënd, ky titull çalon pak, por për moshatarët e mi, që janë pothuajse në mesin e dekadës së tetë, mendoj se nuk ka të sharë. Këto dy qendra, ndër më të banuarat e të vizituarat, janë e mbeten synimi i çdo vizitori, pa harruar se Alpet e Shqipërisë, akoma të pastuduara sa duhet, kudo kanë bukuri marramendëse që befasojnë, klimë të shëndetshme e shumë burime ujë.

Popullimi, veçanërisht kur natyra vesh petkun e blertë, është i konsiderueshëm, lëvizjet e komunikimet e ndërsjella mes rajoneve e krahinave, fshatrave e qytezave, lartësive e pllajave të buta, bjeshkës e vrrinit, janë një dukuri e zakonshme, ku mbizotëron komunikimi ndaj izolimit.

Qafat, luginat, shtigjet e ngushta e më të gjëra, të fshehura e më të hapura, të ditura e të paditura, të gjetura e të pagjetura, të zbuluara e të pazbuluara, shumë rrugë këmbësore, por edhe automobilistike, (ndonjë e asfaltuar), krijojnë lehtësi udhëtimi e befasi të këndshme, aventurë e relaks, për çdo udhëtar a turist, para atij misteri akoma të pandriçuar, që shtrihet në veri të Drinit e deri jashtë kufijve të sotëm shtetëror të Shqipërisë.

Duhet ta kesh shëtitur e parë disa herë, të jesh i pajisur me dhunti e njohurishkencore, gjeograf e gjeolog, biolog e historian, inxhinier e arkeolog, për të përshkruar si duhet Bjeshkët e Namuna, (të bekuara), Malësinë e Madhe, Jezercën, Radohimën, Luginën e Shalës e të Shoshit, të Vermoshit, të Cemit, Përroin e Thatë, të Valbonës, Currajt e Nikaj –Mërturit, Lumin e Gashit e Tropojës, pyjet shekullore, liqenet akullnajore në lartësi të mëdha, e sa e sa pasuri të tjera nën e mbitokësore.

Nga çdo anë që të fillosh, nga Kopluku e Boga, nga lugina e Malësisë së Gjakovës, apo nga Fusha e Shtojt e Kiri, nisja është e butë dhe e ëmbël e, si me magji, joshja sa vjen e shtohet, madje kthehet në ankth e padurim, ndonëse në çdo kilometër që kalon, rritet lartësia mbi nivelin e detit e vështirësia sa vjen e shtohet. Lëvizja me makinë, për t'u afruar deri në portat e kësaj parajsë, të krijon lehtësi e mbështetje.

Këtë herë, nisja ime ishte nga Shkodra, pas detyrimesh që pata për disa raste gëzimi e hidhërimi të ndodhura muajt e fundit, kur unë isha jashtë vendit. Gjatë rrugës, në të dy anët e deri ku fillon Luginë e Bogës, shohim ndërtime të shumta, lokale private e objekte social-kulturore, ara e livadhe, vreshta e pemëtore, rrugë e rrugica të shtruara, oborre e lulishte me shije, që nuk kanë të sharë edhe në fshatrat më të zhvilluara të Evropës. Nuk ka dyshim se mendjet e fryma civilizuere e këtyre malësorëve, me mundin dhe djersën e tyre, ua ndërruan pamjen kë-

tyre mjediseve e vetë qytetit të Koplikut, përballë edhe ndonjë mendimi dashakeq e të zmadhuar se lulëzoi korrupsioni e kontrabanda në këto vite tranzicioni. Ndonëse është e disataherë, unë prape se prape, nuk ngopem së shikuari atë pamje e atë natyrë, plot diversitet: toka pjellore, sipërfaqe të tëra me vreshta e pemëtore në prodhim, jonxha e livadhepër kullota, por dhe të tjera të pashfrytëzuara, "shpërthime" interesante shkëmbinjsh të mbirë nga toka rrethuar me pyje e gjelbërim, male e kreshta malesh, ultësira e lugina, gropa tektonike, kodrina të zhveshura e toka jo-produktive, që ua lëshojnë vendin përsëri tokave pjellore, prozheve me lajthi, arra e gështenjë. Pa dashje mu kujtua shprehja: "Nuk ka toka të këqija, por ka bujq të këqij".

I përhumbur e i kalamendur, nanuritur

dojmë në rrugën e ngushtë, të shtruar me asfalt, që të çon drejt Bogës.

Retrospektivë e nostalgji

Para 11 vitesh, këtë rrugë për Dukagjin-Theth-Shkodër, e kam përshkruar, por me kah të kundërt nëpër Kir-Gur i Kuq-Mali i Shoshit-Breg Lumi-Theth-Shkodër. (Më vijnë në ndihmë edhe shënimet e ditarit të datës 10.08.2010 të cilave po ju përmbahem 100% me ndonjë pasurim apo redaktim të pjesshëm). Po përdor digresionin.

Shkodër-Kir-Dukagjin, me fugonin e linjës, u nisëm në orën 7<sup>00</sup>, me shofer Petrit Koçekun.

Të parin udhëtim për në pedagogjiken e Shkodrës "Shejnaze Juka" e pata bërë në shtator 1963, me babain tim, afërsisht tre ditë rrugë nga vendlindja.

Rasti tjetër dhe më dramatik: Shkodër-Kir-Brashtë e Shoshit- Bricë, për një rast

Pushimit të punëtorëve, atëherë kur një grup artistik i Nikaj-Mërturit, dha një program artistik në disa qendra banimi. Kiri i ngushtë, me pak tokë e ujë, në të shterur gjatë verës, ruaja përfytyrimet e përshtypjet fëminore, se kishte më shumë hapësirë, por jo. Në Breglumi Shalë, qëndrova afërsisht 3 orë e pimë kafe me shokun tim të pedagogjikes Gjelosh Çardakun.

Sot në fushën e Thethit, funksionojnë disa kampe shtëpi me turistë në rritje, por jo dhe aq shumë, ( para viteve 90-të, asnjë i tillë privat).

Masive të mëdha shkëmbinjsh gëlqerorë të thepisur, reflektojnë ndjeshëm në rritjen e temperaturës në diell. Burime të shumta ujore nga shpatet anësore e lumi dydegësh me ujin kristal, na freskojnë e hijeshojnë gjithë luginën. Në ato hapësira që të zë syri, përveç shkëmbinjve relativisht të lartë e deri tek ata të përzier me retë, po të vësh me kujdes, zbulon lehtë skuta me livadhe të fshehura të bukura e me hije, me sipërfaqe të konsiderueshme.

Në luginën e Shalës, buzë përrenjve e lumit, më shumë pashë shkurre, frashër e shkozë, lajthi e shqeme; sa më në lartësi, masive me ahishte, pisha e bredha. Sa më shumë ngjitesh e ndjen veten më të pushtetshëm, por zotëruese, mbeten padyshim majat e kreshtat e larta, madhështore e hijerënda, që dashje pa dashje të shkaktojnë në thellësi edhe një ndjenjë të lehtë frike, veçanërisht kur shikon honet e thella e të errëta poshtë Qafë Tërthores, ato kanyonet e Kaprrejt e Ndërlusës (Ndërlumas). Të impresionon e të drithëron 1 km rrugë e ngushtë ku mezi kalon një makinë e vogël, me gomat anësore buzëshkëmbit të thiktë e të lugtë, e poshtë tij qindra e më shumë metra humnerë e frikshme, hijerëndë, e mistershme, drithëruese, por e bukur e madhështore, pse jo dhe me histori tragjike të njohura. Dramacitetin e rrëqethjen na e shton dhe më shumë, kur shofer Lushi, kthen kokën pas e bisedon me plot pasion.

Në krahun e majtë, shtrihet ky mister i pashoq me kreshta të mrroluna, të thepisura e të ashpra, me hone, guva e kanyonet, me rrasa qindra metra katrore, të lugëta e të mysëta, me mjedise të errëta, ku rrallë fort hyn dielli (apo fare), ku nuk shkel këmba e robit, të ngjajnë me malet gjigande të Himalajës, mister që shtrihet nga Kiri e Cukali deri në Qafë Pejë e Qafë Valbonë, prapa të cilave fshihen mistere e madhësi të tjera të pazakonta.

Lugina e Bogës, shumë e bukur, zbret ëmbël nga kreu (Qafë Tërthore), deri në fund. Mësipërmes, rruga e makinës, përgjithësisht e mirëmbajtur shumë më mirë se sa rruga tjetër Shkodër –Mali i Shoshit- Theth. Në ulje, në krahun e djathtë, një pllajë e bukur shumë, me një gjelbërim të dukshëm, por edhe shkëm-



Frrok Vukaj me turistët e huaj në Qafën e Valbonës, 1800 m mbi nivelin e detit



nga lëvizjet e makinës e ajri i freskët i mëngjesit, me rrezet e diellit jetëdhënës, majtas sapo lamë rrugën që të çon në pikën turistike me famë, Razmën, e vazh-

fatkeqësie, kur një shokut tonë iu aksidentua vëllau në Dajice (1972).

Hera e parafundit fillimi i viteve '80: Lekbibaj-Breg Lumi-Theth-Kampi i



binj relativisht të lartë e të thepisur, mes tyre lëndina e pllaja jo të thyera, të shtrura e të ëmbla, ku mund të kalojnë lirshëm njerëzit e gjëja e gjallë.

Unë u befasova me gjelbërimin e muqulluar, sidomos të shpateve, sepse është pothuajse mesi i gushtit, "Kanë ra gjatë gjithë verës, riga shiu, - më shpjegoi një bashkëbisedues".

Një ndjesi negative nga trungjet e prerë pa kriter në shpatet e maleve, sigurisht për tregti dhe ngrohje.

I gjithë krahu i majtë i luginës, në pjesën dërmuese, kishte pyje të denduratë paanë, që degradonin në shkurre e më poshtë në fusha me bar. Të tërhiqte vëmendjen një kreshtë imponuese, që rrinte varur gati për të rënë poshtë. Sa më në jug, këto pllaja mbulohehin me shkurre e diku-diku qilimi i blertë i livadheve zbehej për t'ua lënë përsëri vendin hapësirave pjellore të Malësisë së Mbishkodrës. Këto hapësira janë të bukura sa nuk thuhet, por duhen më shumë investime nga organet shtetërore e sektori privat, sidomos për ujin e pijshëm e vaditës, çka do të ndikonte shumë në rritjen e turizmit e rritjen e prodhimeve bujqësore e blegtorale.

### Theth-Valbonë,

#### perlat e Alpeve (sprova e ditës)

Ky udhëtim i sotëm i 7 korrik 2021, si i thonë për kokërr të qeftit, më ngjan me një simfoni, të bukur muzikore, me një dasme në Eposin e Kreshnikëve, një shëtitje e relaks, por dhe me një sprovë djaloshare, në moshë pleqërie, si një aventurë pasioni për natyrën.

Gjin Logu punon prej 29 vitesh shofer i linjës Shkodër-Theth, pothuajse pa asnjë ndërprerje, përjashtuar rastet kur rruga bllokohet nga stuhitë e borës. I lindur e i rritur në Theth, i njeh mirë këto bjeshkë e flet me aq siguri e saktësi, si për rrugicat e shtëpitë e lagjes. Sa më shumë e ngacmoj në biseda, më ngjan me një enciklopedist për krahinë. I kërkoj e ai flet pa nda për gjithçka e pyes, madje siguria e pasioni e nxjerrin edhe jashtë pyetjeve interesit tim. Ai flet e unë regjistroj me sa mundem, në mendje e në bllokun e dorës, shënime me shkrim të deformuar prej tronditjeve të makinës, në atë rrugë të ngushtë me asfalt, deri diku të degraduar nga vitet e agjentët atmosferikë.

Veçoj Majën e Helmit, të Troshanit, të Dobranës, Shtegun e Dhenve, Gropën e Bortës... Ndërpritet biseda se mu buzë rrugës, shohim një befasi të këndshme e të pazakontë për kohën, mbetjet e një orteku bore. Vazhdon Gjini e unë me sa mundem, përpiq sa më shumë informacion e shijoj ato pamje përrallore, hijerënda e madhështore. Qafa e Tërthores, më e larta qafë në Shqipëri, e lidhur me rrugë makine (1766 m mbi nivelin e detit). Nga gropa e Bortës, rrugë këmbësore për tek Gryka e Shtegut të Dhenve, për në Theth; kjo është rruga e hershme, më majtas rruga tjetër për Radohimë që del në Vuthaj e Nikç. Tashti nuk ndjejmë më rrëqethje mishi, as drithërima frikësuese, kur kalojmë në atë rrugë dikur shumë të ngushtë e problematike, sepse është zgjeruar bollshëm, punimet e përgatitjet vazhdojnë edhe për hedhjen e asfaltit, por me sa kuptova, ende ka shumë punë. Sidoqoftë, ajo do të përfundojë, e kjo është një sukses i merituar e i vonuar për këtë traserrugë të

hapur që në vitin 1938.

Një ndalesë e nderim domethënës pranë memorialit të zonjës së nderuar Edith Durham, për veprën e saj e të shumë eksploruesve të tjerë, që shkruan me aq dashuri, për këtë popull fisnik me rrënjë ilire të pacenuara. Si kushdo, edhe unë, kërkoj me sy, ish kampin e famshëm të Thethit, i vetmi në krahinë para viteve 90-të, por disi u zhgënjeva, se nuk mu duk në nivelin e emrin e dikurshëm. Me gjithë digresionet e ndërprerjet e bisedës, gjeografia mbetet tema kryesore, ndaj përpiqem për të fiksuar e saktësuar shtrirjen e Jezercës, Radohimës, Majën e Arapit, Qafen e Pejës e të Valbonës, Qafën e Derëzave (derë), që lidhen me Curraj e Epërm e Kakinë, tej në horizont Maja e Hekurave, Biga e Gimajve, mbushur me borë etj.

Në këto ditë të nxehta korriku, ku qielli është pasqyrë e gjelbërimi jetëdhënës i paanë e i plotpushtetshëm në çdo qelizë të jetës, madhështia e këtij mjedisi është imponuese, hijerëndë, madhështore, me të gjitha ngjyrat e ylberit, por edhe me një zymtësi të perceptueshme në kanionet dhe guvat e thella, në brendësi të ahishtave, në faqet anësore e rrëzë shkëmbinjeve si vampir ku nuk hyn drita e diellit. Është rritur numri i turistëve dhe ndërtimeve. Gjini e vëllai Ndreka janë në valë pune.

Nga ora 10, mbaron pjesa hyrëse e këtij udhëtimi, ajo më e lehtë e më relaksuesja, si një nxemje shkriutuese, para një derbi të fuqishëm futbollit. Pasi u përshëndeta me shoferin dhe me disa pasagjerë, fillova rrugën disi ëmbël e qetë. Pas pak minutash, në një nyje ndarëse, sinjalistika tregon të njëjtën shifër kilometrazhi me Qafën e Pejës. Ajo nisje e butë, shpejt u zëvendësua me një të përpjetë të thekshme, me kthesa, zikzake këndore fare të vogla që nuk të lejonin as me u mbush plotësisht me frymë. Cicërimat e zogjve dhe shushurimat e mbytura të një përroi me shumë ujë për kohën, më shoqëruan për disa kilometra rrugë, por së fundi bashkudhëtarët e mi, ishin gjinkallat me këngën e tyre monotone, edhe pse lartësia mbi nivelin e detit, po rritej dukshëm. Në ato të përpjeta pothuajse të thikta, me ca thyerje të pjerrëta e rrallë ca metra në rrugë të rrafshët, me gjithë lodhjen e gufosjen, kisha mundësi për meditime e relaks në ndonjë lëndinë, në hijen e lehtë e shplohëse të aheve e më në lartësi, të pishave interesante. Sinjalistika ishte e qartë e nuk kishe ndjenjën e pasigurisë se ngatërron rrugën apo të mungon koha, se shumë orë na ndanin me muzgun e mbrëmjes.

Nuk e ndjeva frikën as vetminë, se krijova një marrëdhënie të ngrohtë e komunikuese, një ekuilibër të gjithanshëm me natyrën e meditimet e mija të pafund, madje bëja edhe një lloj enumeracioni, një inventar në mendje, për gjeografinë, historinë, për bëma e personazhe real e mistik, për luftëra e ekspedita, për heronj e heroina, për qëndresë e mbijetesë shekullore të këtyre trevave. Një simbiozë e çuditshme në malësi me grykat e qafat. Qafa e Pejës, shpesh herë një portë ferri, nga kanë sulmuar pabesisht ushtri të shumta pushtuese, por dhe një istikam qëndrese, një kala e pathyeshme, ku kanë thyer qafën e lënë kockat, ushtri të shumta gjakatare, osmane eserbo- mala-

zeze. Mbijetesë e vështirë e këtij populli e qëndresë titanike, përballë ekspeditave ndëshkuese e shfarosëse të huaja, por dhe vitet e diktaturës, një sprovë e rëndë. Shuk Kola, nga kjo qafë arratiset për një jetë më të mirë në Amerikë, me dhimbjen e pashuar për vendlindjen, për trojet e të parëve, len peng një pjesë të zemrës, sofrën e shtruar e ibrikun me raki. Bujarinë e traditat më fisnike të krahinës i trashëgon dhe sot familjarisht në kontinentin e largët. Edhe fantazia më e guximshme, nuk rrok dot çka ka ndodhë në këto hapësira: kode e tradita të shkëlqyera për mikun, për besën, për lirinë, për nderin, për qëndresën e paepur ndaj çdo agresori, por edhe mendësi frenuese e barbare, duke ngrënë kokat e njëri-tjetrit mes fiseve e lagjeve. Sa energji e shekuj të shkuar dëm!

Nuk e mendoja se do të takoj kaq shumë turistë, në këtë udhëtim të vetmuar, mbase mbi 100, që vinin nga Valbona dhe flisnin shumë gjuhë

U befasuan një çift francez, kur në mes ahishtës shekullore, thirra me të madhe "Buzhu", një ndër fjalët e pakta që dija. U hodhën përpjetë nga gëzimi e u ngazëllyen shumë, por shpejt e kuptuan mangësinë time. Mangësi do të ishte edhe mos përmendja e Okolit, Gjellajve, Gjeçajve, Syrit të Kaltër, Ujëvarës Grunas, Vaskave - vepër natyrore e krijuar ndër shekuj.

Kilometrat e fundit për në Qafë Valbonë, 1800m mbi nivelin e detit, ishte sprova më e vështirë. Edhe në ato lartësi, tashmë disi të zhveshura, me rrasa e me shkëmbinj gëlqerorë, temperatura qe e lartë. Ca pisha si kaçube, e ndonjë shkurre e përkeqësuar, e dëshmuar nga ortekët, ku nuk mund të fshihte kokën asnjë fëmijë i vogël, patjetër se duhej kaluar me vullnet e këmbëngulje. Dalja në atë qafë, në atë pike ndarje strategjike, të ngjan si një triumf e fitore, që të shumëfishon forcat e energjitë, aq më tepër kur para syve, shpërfaqen pamje përrallore, të paimagjinueshme as në fantazitë më të guximshme. Ato që lashë pas shpine, të shijuara gjatërrugës, por më së shumti nga largësi të mëdha, më ngjanin si fluide e irrealë, ndërsa këto i kam mu përpara syve, i shkela me këmbë e i preka me dorë ortigjet e shumta të borës, lëndinat me barë, currila ujë gjysmë të ngrirë nën hijen e shkëmbinjeve super gjigande, kullotat alpine, monopate e shtigje shumë të ngushtë e pak më të gjere, shkallë e shkallare të denja edhe për alpinistë të sprovuar, sheshe të vogla e humnera, hulli bore e zhavorri të përzier, pisha e bredha të thyer e të rrëzuar, dëshmi e betejave të ashpra të dimrave të egër, ( ky dimër i kaluar me reshje të mëdha bore). Ndonëse kishte kaluar mesi i ditës, nën hijen e shpellave gjigande, bora e shndërruar si në akull, pothuajse nuk lotonte fare. Duke u ulur luginës, të zgjerohet horizonti deri poshtë në rrjedhën e Valbonës e aq shumë ortigje gjithfarësh shihje, sa nuk mund t'i numërojë. Aq shumë masive me pisha e bredha e aq shumë shkëmbinj gjigandë me kilometra të gjatë, sa mendon sikur je në një botë tjetër, në legjenda e mite të papërfytyrueshme, me qenie mitologjike, me kuçedra e dragonj, me Vapir e Vampir, me orë e zana, me shtojzovalle të hijshme e të gjata të veshura me vello bore. Për një moment sikur u shpërfytyrova, truri i de-

hur u paralizua e projektoi ca si pamje të fanepsura e të pazakonta, mbi rrasa guri disi të pjerrëta: shumë turiste në rroba banjo, po ngroheshin e merrnin rrezet e diellit, pranë ortigjeve me borë. Zbritja jonë qe shumë më e lehtë e përshëndetjet e dhjetëra turistëve, ma bënë rrugën edhe më emocionuese. Mbase humba edhe të qenit realist, nga dehja romantike me natyrën, por shpejt rashë aty ku zë fill burimi i Valbonës, ëndërr e çdo turisti apo ëndërrimtar pasiv apo aktiv.

Rreth e rrotull, me dhjetëra turistë të tjerë, freskoheshin në ujët e akullt, lëviznin hareshëm, këndonin e bënin fotografi. Janë skena të papërsëritshme që nguliten në memorie e nuk harrohen. Balbona e Nikë Shytanit, siç e thërrasin vendasit, është unikale për shumë tregues: lartësitë e mëdha ku burojnë dy degë ujë të konsiderueshme që pasurohen nga të tjera gjatë rrjedhës, ujëvara interesante, kaltërsia e ftohtësia e ujit, mjedisi brilant rrethuar me pisha e ahe, tokë humusore përzier me gurë gëlqerorë, ortigjet e bora ushqyese, ajri jetëdhënës, hijet çlodhëse, lëndinat e vogla e gurët e ngritur për të pushuar e vrojtuar, njerëzit e mrekullueshëm vendas dhe të huaj, rrogamas e valbonas, për të cilët do të flas më vonë. Nuk dua të shkëpus fillin e mendimeve, as t'i largohem momentit pikant emocional. Kjo pikë e thjeshtë turistike në natyrë, ku mblidhen shumë turistë, udhëtarë, qejflinj e hallexhinj, quhet "Simoni kafe", me pronar Pjetër Gjellaj e vëllezërit e tij (Arbeni e Gjovalini), biznes familjar i hapur që më 2011, pasardhësit e Nikë Shytanit, nga Gjellajt e Thethit, autoktonë në tokat e të parëve.

Është folur e shkruar shumë për këtë luginë e rrethinat e saj, për të cilat kam shkruar edhe unë më parë, ndaj nuk po zgjatem për këto mjedise në kufijtë të pabesueshmes, nuk po flas për Majën e Krasniqes, të Valbonës, Rrogamit, Papolukës, Rosit, Majën e Thatë, Kollatën, Majën e Valit, e pas tyre hapësira të tjera të paana deri në Kosovë, e Mal të Zi, por për heronjtë e bjeshkëve..

Fisnikëri e mbijetesë- binom i pandarë.

Zhvillimet e fundit sikur na kanë ftohur zemrat, diku-diku të bëra akull, kur pasuria u ka errursytë. Por jo kudo është kështu: tek njeriu i thjeshtë ka aq shumë vlere, sa, ata me pak ose hiq vlere, nuk mund t'i shohin.

Nostalgjitë e kujtimet e mia për Shkodrën nuk shuhet, aty ku kam kaluar vitet më të bukura të jetës: studimet e mesme e të larta. Sa herë vij, është balsam për mua. Nuk harrohen rastet e gëzimit, kafet e bisedat, pritjet e ngrohta tek dajallarët, kushërinjtë, shokët dhe miqtë e shumtë. Të përmendësh emra është vështirë, por disa mbiemra po i shënojmë: Vukaj, Kroni, Përvataj, Thermosi, Piniqi, Palnikaj, Hasanaj, Kolpepaj, Kolbuçaj, Camaj e të tjerë. Si gjithnjë, pranë meje i gjindshëm e buzagaz Sokol Palnikaj, me të cilin kalojmë orët pa u ndjerë, me diskutime të gjata e cilësore në shumë fusha.

-Sonte të pres në shtëpi, jemi lirshëm, të shoqëroj unë me makinë.

Telegrafisht në oborrin e shtëpisë në Vrakë, përshëndetemi me Bardhën, bashkëshorten e Sokolit, ish nxënësi ime, e bija e të nderuarit Pal Mirashit të Palçit, infermiere me përvojë të gjate, pasionante



# KOLË PROGNI LA TRASHËGIMTAR MA TË MIRIN DJALË TË NIKAJ MERTURIT

Pavluë kazani i ditës së sotme zërmëç kolegu dhe mik i Kadri Fikaj më tha në telefon:


- Po pate kohe hajde e merre monografinë Nikaj Mërturi të Kolë Prognit. E dija se ishte në proces, shkova mora medëshirë dhe dhimbjepasi do kisha dashur ta merrja nga dora e autorit. Nen përkujdesjen e letrartë Kadriut, "djali i vetëm i Profesorit", erdhi në jetë, i mirë pritur i shëndetshëm, por edhe gjurmëlënës.

Jam në lexim e sipër dhe ende nuk mund të bëj një analizë të plote siç e meriton ky botimi kopsiturshkencor dhe enciklopedik. Autori gjithmonë është tërhequr nga hiret joshëse të bukuroshes magjistare gjeografi se, sa të lozonjares poligame histori.

Kolë Progni në moshën më vitarapojmes një Bedilendi (reliev shumë i përthyer gati i pa kalueshëm). Deluvionet dhe relikte të tij shumë vjeçare, sot gjenden të mishëruara në këtë kanonike, e cila në aspektin gjeografik, gjeologjik, gjemorfologjik, orografik, oron-

imik, hidrografik, klimaterik, demografik, florës e faunës, resurseve dhe atraksioneve flet veç.

Monografia "Nikaj Mërturi", në këtë




prizëm është jo vetëm kryefjala dhe kallëzuesi i studimeve të deri sotme, por edhe majamë e lartë, mbi të cilën Kolë Progniguliflamurine tij. Kostumitfin gjeo-

grafiktë Nikaj Mërturit, prerë, qepur dhe ujdur nga doratë mikut tim të vjetërnuk i mungon as gjë, dhe nuk ka çfarët' i shtojë as ti heq askushtjetër.

Kush do të mësojë rreth mozaikut të Nikaj Mërturit libri i Kolë Prognit i ka të gjitha të thëna me autoritet shkencor maksimal. Akoma nuk kam hyrë në turrën e amforave historike, që na ka servir autorit, por dita e mirë duket që në mëngjes. Është gjysma, tjetër një medaljon që kërkon një vlerësim tjetër.

Kolë Prognit diq i pa nënshtruar prej thundrave të pa mëshirshme të pleqërisë dhe prehet i qete në amshim. Ai la trashëgimtare: DJALINMA TEMIRIN NIKAJ MERTURIT. Dje, sot, nesër dhe nga mot asnjë frymorë sa do veçantë i Nikaj Mërturit nuk peshondot sakreshtat dhe personalitet që autori me dashuri i ka bashkuar në tryezën e tij bujare.

**Prele Milani**



dhe e përkushtuar për profesionin. Kafën e mbrëmjes me Sokolin e pimë në një lokal cilësor me emrin "Havana".

Bije zilja. Bardha pyet nëse duam për darkë peshk apo mish...

Mëngjesin tjetër po aty, Sokoli më prezanton me shoferin e pronotuar për udhëtim e më uron rrugë të mbarë. (Nuk harron të më marrë disa herë në telefon gjatë rrugës). Më bije në sy ai lokali në Bogë, mikpritja e sjellja dashamirëse e pronares, e cila nuk u zhvatë me zor lekë klientëve, por i këshillon të pushojnë edhe po nuk morën gjë, ndonëse ka xhiro fare të vogël. Si pa dashje, më kujtohet puna prodhuese e vitit 1972 në Bajzë, kur isha student e sjellja bujare e çdo fshatari, kur merrnim fiq, rrush a ndonjë pemë tjetër. Rreth një orë para se të arrija pikën më të lartë të ngjitjes, u ndala në stanin e Dedë Rrgallës, më shumë për të pushuar se sa për kafe. E zonja e lokalit, një meso grua që shërbente, më shikon disi me interes e më pyet nga jam.

Pasi u përgjigja, u shpreh në gjuhën karakteristike vendase "Uuuu qyqja! Po unë të kam pas mësues e drejtor, mezi të njoha". Sigurisht se vitet e bëjnë punën e vet. Mire Gjon Rrgalla, e bija e Nikoll Gjonit të Perajve, shërbente me mirësjellje për të gjithë, ndihmuar nga e bija Valentina, nxënëse në gjimnazin "Oso Kuka" Shkodër. Më erdhi mirë, kur pashë se ishin të përkushtuara, sidomos për vajzën, se një pjesë e mirë e brezit të ri, po e përbuzin punën. Me gjithë këmbënguljen time, nuk pranuan të paguaja për sa kisha konsumuar. Kuptova se e bënin si respekt e mirënjohje për shkollën, për ish mësuesin dhe shoqërinë me babain e ndjerë.

Edhe një herë po kthehem tek burimi i Valbonës, tek Pjetër Gjellaj, pa qenë i njo-

hur me të, në bisedë e sipër, u miqësua e ndenjem gjatë; 9 vite kishte qëndruar në Nju-Jork, shumë i afrueshëm e komunikues, Rreth e rrotull tij me dhjetëra turistë, udhëtarë e shoqëruar. Shërbente thjeshtë e me dashamirësi. Komunikonte edhe në anglisht. Rreth tij, në atë lokal të hapur e ngritur me mjete rrethore, secili e ndjente veten, si në shtëpi të vet. Po veçoj grupin polak, me të cilët qëndruam gjatë. Ne ecëm si udhëtarë me ta deri në Rogam e ata për Valbonë: Daniel Kobierski, Olek Mazur, Ala Potrava, Aleksandra Nabaglo, emra që i shënuan vetë në bllokun tim.

Në një hapësirë pushimi, Petritimë ftoi për drekë, më e mira e më fisnikja, se në asnjë restorant modern. Më qerasi me një kokë qengji, me prodhime të tjera bio: raki, djathë, kos, verë, ndonëse edhe unë nxora në atë sofër bujare dhe ushqimet e paketuara nga nusja e Sokolit qysh herët në mëngjes.

U takova edhe me disa të rinj: Vëllezërit Dardan e David Prekë Jubani e Mefat Hysa, transportues valixhesh, shoqëruar në atë rrugë të thyeshme e me shumë pragje e shkallë, jo vetëm për mushkat e ngarkuara, por edhe për njerëzit. Me bujari e këmbëngulje, më ftuan për në shtëpi, po kisha një planifikim tjetër. Përveç punës që thamë, vëllezërit Jubani kishin edhe një ekonomi ndihmëse: 70 dhi e 10 kuaj, 100 pula, tokë të mbjella me patate e prodhime të tjera, duke qenë ndër të paktit dimëruar, bashkë me prindërit. E ndjenin mosfunksionimin e rrjetit telefonik, problemet me energjinë elektrike, mosmirëmbajtjen e rrugës këmbësore për të cilën kanë punuar privatisht e të tjera mangësi. Darka në shtëpinë e Lulash e Dedë Zef Shelnishtës, një derë e përm-

dur në Tropojë e Dukagjin, që e ngrohtë dhe miqësore. Në buzëmbremje edhe vizitorë të tjerë për një kafe e shkëmbyer biseda, një mënyrë për të thyer heshtjen e monotoninë, që kanë zonat e thella, por edhe shprehje e mirëkuptimit e harmonisë.

Në thellësi të Valbonës, në veri Rogami i Shalës, magjik e i papërsëritshëm, por me probleme aktuale e të trashëguara: nuk ka biznese të mirëfillta, por shtëpi që përpiqen të mbijetojnë, nuk kanë mundësi të bëjnë ndërtime të reja apo rikonstrukcion shtëpive të vjetruara nga mosha e dimrat e egër, për pamundësi ekonomike e ligjeve disi ekstreme. Nën zë flitet se u bëjnë diferencime për arsye konkurrence. Edhe rruga afërsisht 5 km për në Fushën e Gjësë, e populluar shumë gjatë verës, krijon vështirësi të tjera serioze.

Ai zall gjigand i Thethit e Valbonës, aluvionet me zhavorre masive e gurë të mëdhenj, ja zbehin disi bukurinë këtyre perlave, ku duhet vënë dorë me fonde të veçanta.

## Epilog: një vizitë tjetër mbresëlënëse në Valbonë

Kjokafe e 6 gushtit të këtijviti (2021) që më e këndshme se në çdo resort a palat mbretëror, me mësuesit nga Mirdita, Mark e Davida Kalaj (Çoku), me djelmoshat shoferë Nor Hysa, Fred Vukaj e Dionis Shelnishta, që tolerojnë edhe çmimet për bashkëqytetarë e të njohur. Motër e vëlla, me banim në Durrës e Tiranë, të vlerësuar për punën disa vjeçare në arsim, kanë ardhur për një guide turistike në Tropojë. Vizitat në Nikaj-Mërtur, në qytetin e transformuar vitet e fundit, në brigjet e Valbonës, në Bujan tek shtëpia e Mic Sokolit, në HC e Fierzës e së fun-

dit kjo në Dragobi e Valbone, kanë qenë mbresëlënëse, madje Marku ka bërë edhe një shkrim përshkrues e vlerësues për këto bukuri e arritje. U gëzuam për jetën e tyre aktive e dobiprurëse: Marku merret me shkrime e botime, ndërsa Davida prej vitesh jep mësim në një shkollë jo publike, ndonëse në pension. Bisedat miqësore e të harlisura nga fresku i mbas ditës, prekin edhe çështje sociale, për një shërbim sa më të kulturuar e prodhime vërtetë bio, për sistemim e trajtim rrugësh e ujërash të zeza, mirëmbajtjen e ruajtjen e Parkut me punonjës vendas, për harmoninë mes fshatrash e krahinash, mes besimeve e divesitetit politik, për vizitat e ndërsjella në raste festash e të tjera.

Hysaj, me prejardhje të largët nga Kelmendi, kujton se gjyshi i tij Avdyll Brahim, ka qenë i vëllazëruar me Shan Bashën e Rogamit, se disa nga festat më të njohura, i lutnin (festonin) edhe besimtarët myslimanë. Furnizimi edhe me kafshë e me krah për Rogamin, ka shumë peripeci e shpenzime. Ky fshat, një margaritar mes atij gjerdani perlash, të duket si i izoluar, i atrofizuar e neutralizuar në kufijtë e krizës, pa përkrahjen e mbështetjen e duhur, që po konsumojnë energjitë e rezervat e fundit. Premtime e pritje të gjata, optimizëm e zhgënjime, dilema e pesimizëm, mes braktisjes së vendlindjes apo mbijetesës së sforcuar. Rritjes e masivizimit të turizmit duhet t'i përgjigjemi me masa konkrete efikase për një shërbim cilësor duke harmonizuar interesat e ndërsjella (shitës - blerës). Ky popull fisnik i Alpeve, aspiro e meriton shumë më shumë. Don Zoti e ëndërrat bëhen realitet.



# DITA E ALPEVE SHQIPTARE VUTHAJ, 2021

Manifestimi Tradicional “Dita e Alpeve Shqiptare” mbahet prej vitesh në Vuthaj, që është themeluar nga Intelektualë dhe mërgimtare dhe mbahet ende me shumë sakrificë nga “dinastia” Gjonbalaj, që jetojnë në Guci dhe Vuthaj.

Grupi jonë “Besa Shoshi”, ishte i ftuar nga organizatorët e kësaj veprimtarie, që në muajin korrik, pasi edhe vitet e tjera anëtar të grupit tonë kanë bashkëpunuar me organizatorët e kësaj veprimtarie. Lidhjet me grupin tonë i mbante moderatorja, valltarja e nderuar znj. Arberore Gjonbalaj. Një vajze mjaft e zgjuar nga fisi Gjonbalaj, që ishte në grupin organizator dhe moderatore e përvitshme e kësaj veprimtarie. Ne, mundem të përfaqësohem vetëm me tre anëtarë, sepse pjesa tjetër për arsye të obligimeve sezonale nuk udhëtoj dot me ne. Këngëtari veteran Kole Martini, Gjëlosh Kola dhe Gjon Kosteri, por grupit tonë si shumë raste të tjera ju bashkëngjit poeti publicisti dhe fotografi i nderuar z. Lulash Brigja. Pasioni dhe njohjet e tij atje, jo vetëm e kompletoj grupin tonë, por i bëri edhe një pasqyrim dhe publicitet krejt veprimtarisë. Gjithçka ishte planifikuar deri në detajet më të vogëla, në udhëtimin tonë tek “Dita e Alpeve Vuthaj, 2021”.

Nuk është hera e parë, që na shoqëron me makine z Tome Gjubini i kujdesshëm, i gatshëm për çdo lëvizje, në vende historike dhe turistike. Ne, u nisem nga Shkodra në mëngjes herët, me datë 1 gusht 2021, ditën e diele, me qellim që të shijonim edhe rrugën, por që ta kishim edhe kohën në kontroll. Një rrugë me standarde të shkëlqyera, humor muzike, por edhe kafe në Tamare e Vermosh. Pasi arritëm në Guci u pritëm nga moderatorja dhe organizatorja kryesore e kësaj veprimtarie, znj. Arberore Gjonbalaj.

Pasi pushuam në Bar “Metro”, ku u bashkuam edhe me koleg nga Malësia e Madhe, nga Kosova dhe Rozhaja, u nisem për tek Krojet “Ali Pashës”, ku konsuam një mëngjes pikant. Aty kaluam pak kohë mjaft aktive, duke vizituar gjithë ato kroje dhe gurra si kristali të pastra, si bora të ftohta, një panorama dhe relief fantastik. Aty grupi jonë bëri edhe shumë foto, që vërtet janë një kujtim i bukur.

Rreth orës 11.00 u drejtuam për tek burimi kryesor i Vuthajve, aty zhvillohet festa “Dita e Alpeve Shqiptare”.

Mes shumë grupeve pjesëmarrëse, gjetëm disa grupe folklorike të njohura në veprimtari të ndryshme dhe të gjithë shumë që kishin ardhur për të ndjekur “Ditën e Alpeve Shqiptare”.

Kishin ardhë edhe nga Shqipëria, nga Kosova, por shumë emigrantë nga diaspora. Koha ishte mjaft e bukur, e kthjellte, ndihej aroma e maleve, që i jepte një freski joshëse. Pasi u veshëm me kostumet tona tradicionale kombëtare dhe u bëmë gati për skenën, dy moderatorët e shkëlqyera të kësaj feste, Arbnorja dhe Rilinda na kërkuan, që ne të hapnim “Ditën e Alpeve Shqiptare”, me një këngë për krye krahu i thonë ata ose maja krahu

apo kënga e gjatë i themi ne. Aty, në moment ideuam dy vargje që i përshtaten rastit, sepse aq rreshta duhen për këngë të tillë. Nuk kishte gjetje më të mirë se sa me këndua për Ali Pash Gusin dhe për Jakup Ferrin, pasi të dy këta luftëtar ishin nga Plava e Gucia. Vargjet e këngës ishin:

“Ali Pasha e Jakup Ferri

Fort po i dron turku e serbi”

Në skenë u ngjiten Gjon Kosteri dhe Gjëlosh Fusha, të cilët interpretuan direkt këngën maja krahu, me shumë pasion,

mjaft e nxehtë krahasuar me lartësinë ku ndodheshim, por një publik i shumë nën ato ambiente të impresionuar që konsumonin pije dhe mish fërliku...

Por, kur jeni pjesë e programit, nuk është mundësia për ti shijosh te dyja. Aty zhvillohet një feste e vërtet popullore. Programi ishte mjaft i pasur me këngë e valle nga të gjithë trojet tona, me fjale përsëritëse dhe recitime.

Grupi jonë interpretoj tre numra: Gjëlosh Fusha u paraqit e interpretoj direkt një këngë lirike “Ka ra dielli

e mbrëmjes për të udhëtuar. U ndalem në Qaf Bordalecit tek Hotel Restorant “Kelmendi” në fakt u nisëm për tek një mik i Lulash Brigjes. Por ai doli edhe miku jonë dhe i gjithë Shoshit, pasi për disa kohe ka punuar zooteknik në Ndrejaj -Shosh, z. Dod Dragu në ambientin e tij familjar na priti me shumë respekt dhe bujari e me humor, biseda nga kujtimet e tij gjate punës në krahinë tonë. Gjithçka ishte prefektë, ushqime bio tradicionale dhe ashtu si papritur shijuam një dreke si të ishim turistë të



energji dhe shumë korrekt nga ana artistike. Pastaj moderatorët Gjonbalaj vijuan përshëndetjet sipas programit. Së pari u ngjit në skenë SHKA “Maja e Karafil-it Plave-Guci”, ku interpretoi dy valle folklorike nga Plava. Pastaj me rrallë u ngjiten në skenë këngëtar dhe grupe valltarë nga gjitha Trojet Etnike. Koha ishte



në shpat e në lugje”; ndërsa Kole Martini u paraqit me këngën “Bukuroshet e Malësisë” dhe Gjon Kosteri u paraqit me këngën “Alpet tona”.

Falënderim i veçantë për kolegun tonë Gjëlosh Fusha, i cili sakrifikoj disa probleme familjare, për të qenë pjesë e grupit. Nuk është nevoja ta themi këtë për mikun nderuar, Lulash Brigja, që pasioni dhe shoqëria e çojnë në shumë veprimtari. Por sot dua ti shpreh mirënjohje për pasqyrimin e shkëlqyer të “Ditës së Alpeve Vuthaj, 2021”, që kjo veprimtari u publikua nga disa media vendase dhe Shqiptare.

Pas rreth tre orë program dhe përshëndetje nga personalitete të ndryshme vendase dhe të ardhur, veprimtaria kulturore e artistike, u mbyll nga moderatorët e nderuara, falënderuan pjesëmarrësit dhe grupet artistike.

Me përfundimin e manifestimit të “Ditës së Alpeve në Vuthaj, 2021”, ne ishim të ftuar për një drekë nga organizatorët, por ajo shtrohej pasdite vonë dhe ne vendosëm që të lëvizim. Vizituam Plavën dhe liqenin e saj piktoresk, pastaj Vermoshin e bukur dhe të freskët. Por edhe pse vonë na duhej një dreke tradicionale për të pritur freskinë

ardhur nga Amerika!

Në mbrëmje vonë pasi provuam edhe freskinë e ujit të lumit Cem, u kthyem në Shkodër. Një dite shumë intensive e lodhshme, por e bukur. Mendoj se, së pari justifikuam vetën, shoqatën, por edhe zonën e Dukagjinit, me pjesëmarrjen në këtë veprimtari. Së dyti ishim një grup i mirë dhe shijuam një ditë të bukur që do mbetet gjatë në kujtesën tonë.

Falënderojmë organizatorët e “Ditës të Alpeve në Vuthaj, 2021”, në veçanti familjen Gjonbalaj që si një “dinasti” më vete punojnë dhe përpiqen të ruajnë dhe të trashëgojnë kulturën dhe traditën Shqiptare në një vend me histori dhe resurse natyrore të spikatura, por që flitej shqip me pikatore. Po i ndajmë me miqtë tanë direkt këto kujtime dhe këto foto, me shpresën se, ne ose ju do të jemi përsëri në atë vend piktoresk, do ta përcjellim edhe për lexuesit e gazetës “Dukagjini”, që të mbetet në arkivat e kohës..

Mirë u takofshim në veprimtari të tjera kulturore dhe artistike!

Gjon Kosteri,  
Shkodër gusht 2021



# PLISI DHE ARMA: KULTURA E MBAJTJES DHE E PËRDORIMIT NË TRADITËN SHQIPTARE

(Kumtesë e lexuar në manifestimin DITA E PLISIT, te Ujëvarat e Mirushës, shtator 2020)



Shkrimtari Prend Buzhala

Në të kaluarën plisi ka pasur vlerën e një formimi të brendshëm të sjelljes, [t] mënyrës së jetesës e të një rituali serioz. Edhe sot mbahen kapela të ndryshme: serioze e joserioze, ushtarake e policore, kësula të infermierëve apo të punëtorëve të ndërtimtarisë. Shohim kapelat e ritualit akademik apo të studentëve të diplomuar, ato të klerikëve apo ato të pilotëve. Secila prej tyre ka kanë mënyrën e vet të përdorimit dhe ritin e përdorimit. Kapela është tregues i një profesioni serioz, por ajo shënjon edhe shumëçka tjetër. Kur hiqet kapela, e kuptojmë se ai njeri e ka kryer shërbimin. Kur hiqet me një dorë, dhe personi përulet, ajo është shenjë nderimi për një personalitet apo për Tjetrin, të cilit i drejtohet. E pra, edhe sot kësula ka vlera semiologjike, shënjuese dhe rituale.

## 1. SEMIOLOGJIA E ARMËS TE SHQIPTARËT

Kështu ka qenë edhe me plisin shqiptar: në radhë të parë ai tregon Njeriun Shqiptar. Ka treguar njeriun, kur shkon për gazmend, por edhe për ndonjë ngjarje tjetër publike apo rituale. Ashtu sikundër shqiptarin nuk mund ta përfytyrojmë pa plis; po kështu, në të kaluarën, shqiptari gjithmonë është përfytyruar edhe me mbajtjen e armës. Shqiptari është portretizuar, ndër shekuj, gjithmonë me armën e tij (shpatën, pushkën, përkrenaren etj.) portretizimi në arte, skulpturim, përshkrime letrare apo etnografike, historike apo antropologjike, gjithmonë kap përmasën trimërore e luftarake të së madhërisë, përmasën epike të tij, rreptësinë e ashpër kreshnike si të maleve. Shqiptari konceptohet diku në peizazhin malor, pranë një kulle të gurtë a një murane luftërash. Aty ku përshkruhen këto elemente, ato merren edhe sot si simbol i qëndresës dhe papërkulshmërisë së tij, si shpirt i karakterit të tij. Nuk quhet më kot Kanuni i Maleve, pasi edhe rendin shoqëror edhe ligjet e rregullat e jetës, ai i ka hartuar vetë kundruall të të gjitha perandorive e pushtuesve. Kurse mali nuk shfaqet vetëm si eponim kulture, jete e urimi ("Të paça sa malet", "Rnofsh sa malet") etj. Por malet ishin edhe vende strehimi e mbrojtjeje nga armiqtë e për të mos u asimiluar. Shqiptari, ndër shekuj, e ka pasur

pranë vetes gjithmonë armën e tij. Pushka shkruhe dinjitetin e shqiptarit, nderin e tij, madje ajo merr edhe domethënien historike të kryengritjeve shqiptare për liri e çlirim. Me pushkë ai mbronte nderin dhe atë liri të pakët, mbronte familjen. Shqiptari e do pushkën sa familjen e tij dhe për këtë kishte një kujdes të veçantë. Pamjet e kullave të dikurshme nuk mund të përfytyroheshin pa armën e varur në mur. Fotot e moçme të të parëve tanë, i shohim gjithnjë me pushkën pranë. Kur lindte një fëmijë, zbrazej pushka dhe bëhej urimi: "T'u rritë e t'u baftë djali për pushkë"! ose urimi: "T'u shtofshin pushkët", d.m.th. urimi që të lindnin edhe bij të tjerë. arma pra, ishte pjesë e jetës, e lidhur ngushtë me ekzistencën e me traditën e sidomos me mendësinë e karakterit të shqiptarit. Me pushkë ai flinte, me pushkë ai shkonte në mal a në arë, në dasmë a në varrim, pa e hequr nga supi. Për ta siguruar armën, ai nuk kursente asgjë tjetër. Kanë lindur proverba të shumta se si shqiptari nuk jeton pa armën, ose shqiptari nuk rri pa armë etj.

Ndryshe, arma na i kujton ato kryengritjet që nga Skënderbeu e këndeje, për të carë përpara në histori, sepse pushka ishte një udhëzues e drejtues nëpër kohët



e vështira. Adhurimi për armën është i shenjtë për shqiptarin. Armën duhej mbajtur e siguruar me çdo kusht. Dhe kjo i ka kushtuar shumë shtrenjtë shqiptarit, sepse regjimet pushtuese es h=shtypëse gjithmonë kanë pasur kërkesat p.l.r çarmatosjen e tij. E ka paguar edhe me jetë, edhe me burgje, edhe me arrestime të panumërta. I dha kuptim gjithmonë domethënës e të ri kësaj qëndrese me armën, siç janë traditat patriotike e luftërat për liri.

Porse ka edhe proverba tjera, që na thonë ë vërtetën se shqiptari e do paqen e jo armën,. Psh: "Arma të bën trim pa qenë", "Arma e ba trim edhe budallën", "Arma asht belaja e kresë" etj. e që duan të na thonë se për armën ka edhe mendime jo të larta.

## 2. SEMIOLOGJIA KANUNORE

### E ARMËS

Sipas traditës shqiptare, mbajtja e saj dhe përdorimi i saj kishin rregulla. I kemi parasysh, bie fjala, rregulloret e rregullat e përdorimit, përkujdesjes e të mbajtjes së armës në ushtri, a në polici.

Po ashtu, edhe te *Kanuni i Lekë Dukagjinit* ka rregulla të sanksionimit të armës. Bie fjala, revolva futet në brez, e jo të mbahet si karagjoz (Xhafaer Martini: "Kanun", Tiranë 2013, f. 464).

E si duhet të sillet njeriu përballë atij që e ka armën në brez? Është shenjë se aët njeri nuk duhet a bezdisësh, kurse të kujdesësh e të matur duhet të jenë të dy palët, edhe ai që e ka armën, edhe të tjerët.

Edhe pushka në sup mbahej me grykë teposhtë, e që është shenjë e vetëpërmbytjes e jo për mendje të madhe. Mbajtja e tillë e armës ishte paqësore (Xh. Martini, po aty) e që shprehte qëndrimin moral të atij që vepronte kështu. Arma nuk i jepej tjetrit për ta mbajtur, se po i vra nga ajo armë jotja tjetri, ti bie në gjak. Ky ishte një rregull

që nuk shkelej.

Në konak, të parën e dorëzon armën, e cila varej në kunj a në një gozhdë speciale për varjen e armëve (Kanuni: "§.605. Falet me mik, armen i a murr, e i prin në shpi.

Thuhej: me armë nuk luhet!

### 3. TAGRI KANUNOR MBI ARMËN

Po ashtu, kishte rregulla, për vende të veçanta, se ku e si ajo përdoret, a nuk përdoret. Kështu, burimet ishin vende ku nuk përdorej arma (Xh. Martini, po aty), e nëse e kërcënoje dikë me armë, paguajë gjobë.

Ishte rreptësishtë e ndaluar t'ia drejtoje armën dikujt.

Dikur arma nuk përdorej për ta frikësuar dikë. Sot ky mentalitet i karakterit të shqiptarit ka ndryshuar në përdorimin e armës si kërcënim, frikësim, për dhunë etj. dikur arma mbahej për të krijuar siguri, kurse sot ajo mbahet për të krijuar pa-siguri, sipas asaj logjikës së ligjit të xhunglës se fiton i forti, pra, jo nderi, respekti etj.

Dikur me armën shqiptari ishte lidhur fort me familjen e me atdheun, se sa sot.

Nga ana tjetër, Kanuni nuk parasheh përdorimin e zbrazen e armës nëpër ahengje, nëpër dasma apo në pirje alkooli, apo kur mbahen kuvende, sepse, në këso rastesh Kanuni e konsideronte vepër të ndëshkueshme.

Sipas Kanunit, i zoti i shtëpisë ka tagër mbi armët e veta:

"§. 24. Tagri i gjindes së ships.

4) Mbi qe ka tager bulku, qi i nget: me i ndimue kuje a uha a falë pa pasë nevojë per leje të zot't të shpis".

Ka për detyrë që, kur vjen mosha e caktuar, e të riut, pra, t'ia sigurojë armën: "§. 21. Perlumi e detyra e të zot't të shpis.

7) Me mbajtë udhen e drejtsis në shpi, e mos me i a mbajtë krahin ma teper njanit se tjetrit;

M'u ble armët djelmvet, kur të shofë se janë ba per to."

Madje, parashiheshin edhe ndëshkime nga i zoti i shtëpisë për keqpërdorim të armës na ndonjë anëtar i familjes.:

"§. 20. Tagri, perlumi e detyra e të zot't të shpis.

b) Me u hjekun armët e krahit a të brezit per nji a dy javë..."

Ka edhe rregulla e norma të tjera për armën te Kanuni:

20, 10: Me hi dorëzanë kush i shpis pertej se i ban arma; me shitë, me ble a me ndrrue gja pa leje të zot't të shpis, ka tager mos mu pergjegjë, se Kanuja së xen per të zakonshme as të shitmen, as të blemen as të ndrruemen e as dorëzanin këso dore, e çdo send a gja do të shkembet, se a'ba pa leje të zot't të shpis.

24. Tagri i gjindes së ships.

3) Mbi armët e veta seicili; munden me shitë, me ndrrue, a me lanë peng, porse s'kan tager me lypë tjetren në shpi;

2) Munden me hi dorëzanë edhe pa e pvetë të zot'n e shpis, porse per aq, sa u ban arma, se kjo asht e veltja;

Te Kanuni Ndamjes hyjnë: trualli, shtëpia, toka, po edhe armët.

Armët i jepen vëllait të parë,



# Pasoja e martesës brenda gjakut



Seksi (martesa) brenda gjakut, përfshin më shumë se një miliard njëerëz në botë. Është shumë e kaherëshme. Njihet që në kohën e Faraonëve të Egjiptit.

Fillimisht është menduar, dhe mendohet akoma sot në shumë kultura, si mënyra më e mirë për ruajtjen e pastërtisë së gjakut, të familjes dhe fisit. Shumë dinasti, mbretëri dhe fise fisnikësh, për t'u mbrojtur nga "infeksioni" i gjakut të huaj, janë martuar brenda gjakut të tyre.

Cilat janë parësitë dhe të metat e kësaj martese?

Njëra ndër parësitë është se, gjaku mund të mbetet i pastër. Brenda gjakut të fisit, nuk futet gjaku i huaj. Të paktën kështu mendohet.

Por, krahas kësaj parësie, biologët dhe psikologët kanë vërtetuar një të metë të madhe: Krijimin artificialisht, të mutacioneve, të cilat sjellin degjenerimin e gjenit të njeriut.

Shumë studime kanë arritur në përfundimin se, te fëmijët e lindur nga prindër me lidhje gjaku, rreziku i prekjes nga sëmundjet trashëguese, është pesë përqind më i lartë.

Nëse fëmija trashëgon të njëjtin gjen të dëmtuar, nga të dy prindërit, gjë që është shumë e mundur, nuk ka shanse zhvillimi dhe të jetuari normal. Janë shumë të njohura rastet e lindjeve me të meta fizike

dhe mendore.

Defekte të tilla, janë shkak i vdekshmërisë së lartë të fëmijët e lindur nga prindër brenda gjakut.

Sa më e afërt që është lidhja e gjakut midis prindërve, aq më e madhe është mundësia e trashëgimisë së gjenit defektoz tek fëmija.

Gjenetiku holandez, Gerard te Meerman, i ka kushtuar një vëmendje të veçantë këtij fakti. Ndër të tjera, ai ka studiuar rastin e Faraonëve të Egjiptit, të dinastisë Habsburg dhe rastin e hemofilisë në dinastitë dhe familjet fisnike të Europës.

Në dinastinë e faraonëve të Egjiptit, martesa brenda gjakut, ishte një gjë fare normale. Madje edhe vëlla-motër.

Te faraonët, hamendësisht, kjo traditë, kishte të bënte me besimin. Perëndia e Egjiptit, Osiris, ishte martuar me motrën e vet, Isis për të mbajtur të pastër linjën e gjakut.

Prindërit e faraonit të njohur të Egjiptit, Tutanchamun (1332-1323 pr. Kr), kanë qenë motër dhe vëlla. Tutanchamun vuan nga disa sëmundje, të lindura dhe të fituara. Kishte këmbët e deformuara, buzën e poshtme të varur, dhe nofullën bashkë me dhëmbët e poshtëm, të zgjatur përpara, dhe skolozë.

Në dinastinë e tetëmbëdhjetë egjiptiane, thuhet të gjithë vuanin nga deformime fizike dhe sëmundje të ndryshme. Ishin me dhëmbë shumë të mëdhenj, të dalur përpara dhe, me deformime të kafkës.

Sipas te Meerman, e gjithë kjo ishte pasojë e degjenerimit të gjenit, nga martesa brenda gjakut.

Në Mesjetë, dinastia Habsburge, ishte më e madhja dhe më e njohura në Europë. Ajo sundonte Zvicrën, Austrinë, Hungarinë, Francën, Italinë dhe Spanjën. Por, jo dhe me njerëzit më të pashëm.

Ishte i njohur fakti që, habsburgasit, vuanin nga deformimi i fytyrës, të cilat

u quajtën "Mjakra habsburgase". Nofulla e poshtme ishte shumë e deformuar, e tejzgjatur dhe e dalur përpara. Buza e poshtme ishte shumë e gjatë dhe e varur poshtë. Gjuhën e kishin shumë të trashë.

Deformimet fizike shtoheshin gjithnjë e më shumë. Por nuk ishte vetëm kjo. Jeta mesatare e familjes perandorake, shkurtohej vazhdimisht.

Perandori, Karli II (1661-1700) e kishte nofullën e poshtme shumë të shëmtuar, të gjatë, dhe i rritej vazhdimisht, aq sa nuk përtepej dot. Gjuhën e kishte aq të trashë sa, vazhdimisht i rridhnin jargët. Kishte dhe një tjetër të keqe të madhe, ishte shterp. Nuk lindte fëmijë. Për këtë arsye populli e mendonte "I mallkuari".

Juan Carlos I, i cili ishte mbret i Spanjës, e kishte prejardhjen nga dinastia Habsburge. Edhe ai e kishte trashëguar nofullën habsburgase.

Meerman e shpjegon degjenerimin fizik të habsburgasve, pasojë të martesës brenda gjakut. E gjithë dinastia, gjeneratë pas gjenerate, martohej brenda gjakut të vet.

Sipas G. te Meerman, hemofilia (sëmundje e gjakut) ishte tipike në dinastitë dhe fisnikët e Europës.

Kjo sëmundje u shfaq tek mbretëresha e Anglisë, Victoria (1837-1901). Ajo ishte bartëse e gjenit të mutizuar, i cili shkakton hemofilinë. Sëmundja solli pasojë shumë të mëdha, në familjen mbretërore angleze dhe atë ruse. Kjo për faktin se, të dy familjet mbretërore u kryqëzuan me martesë.

Mbretëresha Victoria e përcolli gjenin e hemofilisë te djali i saj Leopold, dhe kështu gjeni u përroll gjeneratë pas gjenerate te familja mbretërore.

Është i njohur fakti që, familja mbretërore angleze, u martua me shumë familje mbretërore dhe dinasti të Europës. Nga martesat, sëmundja u përhap, veçanërisht, në Mbretërinë Prusiane dhe

në familjen Care në Rusi. Pacienti më i njohur i sëmundjes së hemofilisë, nga dinastia e Carëve, është Alexei Nikolajewitsch, djali i carit të fundit, Nikolaus II.

Te Meerman, këtë dukuri e shpjegon me trashëgiminë e materialit gjenetik. Pasardhësit trashëgojnë material gjenetik nga prindërit e tyre. Në raste të fekondimit, gjithmonë marrim një kromozom nga nëna dhe një nga babai. Ndodh shumë shpesh që kromozomet janë të dëmtuara, çka do të thotë se janë një shkak për trashëgiminë e sëmundjeve. Nëse te njëri nga të dy kromozomet shfaqet një mutacion (gjen i dëmtuar), nuk ka ndonjë problem. Kjo për faktin se, kromozomi tjetër është i paprekur. Por, nëse të dy prindërit përcjellin të njëjtin gjen të deformuar me mutacion, anomalitë të fëmija janë të pashmangshme. Në shumë raste mjafton edhe një gjen i mutizuar, p.sh. në rastin e kromozomit X te djemtë, pasi ata kanë vetëm një të tillë.

Anomali të tilla, vihen re edhe jashtë familjeve mbretërore, në shtresat e gjera të popullsisë.

Shumica kanë karakter rajonal, krahinor. Turqia, Afrika Veriore dhe shumë vende të Orientit, janë të njohura për martesën brenda gjakut.

Në Turqi thuhet: "Vajza e mirë, martohej brenda gjakut. Vajza e keqe, martohej me të huajt".

Në kulturat patriarkale, fëmijët e lindur me defekte ose që shfaqen më vonë, shkaktojnë konflikte shumë të mëdha, në familje dhe fis. Për gjithçka dhe në çdo rast dështimi, fajësohet gruaja. Në raste të tilla, në Turqi, ajo mendohet "kani boz" (gjaku i prishur).

**Lekë Imeraj,**  
shkrimtar, përkthyes, publicist

berret (delet) ndahen për pushkë, lopë e gjedhe marrin vetëm ata që janë të zotët me mbajtje armë etj.

Te NYE I SHTATËDHETETETË. Përcaktimi i gjojës (gjuetisë), ka një rregull e normë:

§.401. Me dalë 50 vetë me gjuetjtë e me kë në gjyma me armë e gjyma tjetër pa armë, paraz marrin pjesen e gjojës, per arsye se me një qellim duelen në mal. Të pàarmatosunt u apin ndimë tarmatosunvet, kù me brimë kù me rojë e kù me rrethim të vendit.

Te NYE I SHTATËDHETETËT, ku flitet për tregun e armëve, të kalit, thuhet:

§.478. "Pushka e kali e kàn kùj mbë kùj".  
§.479. Po bleve armen, e të thà shitsi: "E bajshë me nderë!", e e vore në krrabë me dorë tande, të mbetë në derë, edhë n'i a gjetsh ndo'i gand mbrapa.

§.480. Arma blehet gjithherë e mbushun. Rregullat e Kanunit parashohin edhe pritjen e mikut në raport me armën e nderimin ndaj saj:

§.615. E mbaitmja e armës është:  
a) shëj burrnija e nderje, edhë pse knaqesh së tërdh miku,

b) është shëj roje, sepsë tui i thànë: "Mirë së erdhe", ajo do të rrijë pa droje, e së giin-desh gadi me i dalë zot per çdo rrezik,

c) është shëj urtije per vedi, pse, 'si ti mârrih armen, edhë në pasët ndoi mende të keqe miku, nuk kà shka të bân si tã çarmato-sish.

§.616. «Mikut i lshohet kryet e vendit».

Te NYE I NJIQINDENANDËMB-DHETËT, ku flitet për dorasin (gjakësin, ai që vriste dikë), në shenjë nderimi ndaj të të vrrarit, thuhet:

§.847. Dorërsi nuk guxon më mârri armen e të vramit, po bani kët faqe të zezë, aj bjen në dy gjaqe.

Ndërkaq, te NYE I NJIQINDEN-JIZETEPESËT, sse çfarë deormitetesh të kanunit e keqkuotimesh ka sot, a na e thotë qartë kjo normë kanunore:

"Gjaku shkon per gisht".

§.898. Në kanù të veter të Malevet të Shqypnis vetem dorërsi bijte në gjak, ase aj, i cilli tëhiqte, shkrepse e shprazte pushken a çdo armë kundra nierit."

§.899. Shpija e të, vramit nuk mujte me ndjekë as me vrà tjeterkend prej vllazensh,

nipash a kushriysh të gjaksorit, pos gishtit dorërsit .

Ose te gjaku për punë të liga:  
§.922. «Mikun e prëm, armët e gruen e dhunueme, kanùja s'i perket.»

Pushka ndjek gjakësin:  
§.954. Pushka e shtime per armë të mar-runu, bien në gjak, por jo në giobë.

Të rrepta janë edhe ndëshkimet për keqpërdorim të armës në rastet tjera, si: po i shkrepri kush kujt armën në Kuvend, shpija i digjet, vrasësi grihet katundisht, e shkon gjakhupës.

## 4. KONTEKSTET KOHORE TË PËRDORIMIT TË ARMËS

Duke i përqsasur këto tradita të mbajtjes, kujdesit e përdorimit të armës, deshëm të theksojmë se në kohë e hapësirë ndryshon edhe kuptimi për armën.

Sigurisht që sot, në kushtet e rrethanat e një shteti ligjor, semiologjia e përdorimit të armës ndryshon, sado që ende mendësia e së kaluarës është kokëfortë. Pajtimi i madh i gjaqeve që u mbajt në fillimvitet '90, është një shteg i ri historik për ta çuar përpara mendësinë e re në rrethana të reja

historike; e që ishte parapërgatitja se arma drejtohet ndaj pushtuesit gjakatar e jo ndaj vëllait. E sot mund të themi, ashtu siç tha një dijetar, historian e profesor amerikan, Alfred Whitney Griswold: "E vetmja armë e sigurt kundër ideve të këqija janë idetë më të mira." Armë të sotme konsiderohen dija e arsimit, sepse "Injoranca ka qenë gjithmonë arma e tiranëve; ndriçimi shpëtimi i të lirëve." (Bill Richardson). Në kushtet e shtetit, janë ushtria e policia ato që e organizojnë mbrojtjen dhe sigurinë.

Porse patriotizmi a dashuria për atdheun e për popullin, për lirinë dhe drejtësinë, në kushtet e lirisë e të demokracisë kërkojnë gatishmërinë, përkushtimin, vetëmohimin, besnikërinë dhe ndjejnë e lartë ndaj detyrës. Atdhetarizmi, traditat atdhetare dhe memorizimi i kësaj trashëgimie, siç është Dita e Plisit, janë edhe një armë e domosdoshme për mbrojtjen e civilizimit tonë nga barbaria e nga asimilimet e tjetërsimet theqafëse të botës bashkëkohore. Edhe në traditën shqiptare pushka ishte pjesë e mbrojtjes së jetës dhe atdheut dhe jo e konfliktit. Mbi të gjitha armët, qëndron faktori kryesor që quhet njeri.



# KËTO JANË GRATË QË MERITOJNË, QË U JAPIN LEKSION JO VETËM SPORTIV SHTETIT E SHOQËRISË NË SHQIPËRI!



BESI BEKTESHI

Jemi mësuar të shikojmë në fokus gra dhe vajza që politika dhe sidomos Edi Rama katapultojnë në shoqërinë shqiptare. Që kanë kontribute zero për vendin dhe shoqërinë dhe bëhen “heroina të politikës dhe të shoqërisë” pa asnjë lartësi merite në asnjë sistem. Jemi mësuar të na bëhen gratë dhe vajzat e shoëbiz-it si drejtueset e shoqërisë përpara në kohë. Imagjinoni projekcionin që merr shoqëria shqiptare në mënyrë kaq të gabuar nga një trill i Ramës politikisht dhe televizioneve mediatisht në Shqipëri. Kurse heroinat e vërteta, vajzat e vërteta të lartësive sublime janë Nora Gjakova dhe Distria Krasniqi. Po po, dy medalistet e Kosovës në Lojërat Olimpikë në Tokio. Ai shteti i vogël pra, që nuk i mbushte syrin as Beogradit, merr dy medalje të arta dhe i jep leksion të qartë dhe të sigurtë gjithkujt. Po sigurisht që po iu jep leksion botës Kosova me vajzat e saj. I ka dhënë gjithmonë Beogradit, por dhe të tjerëve përreth tij. Por unë e kam fjalën te leksioni që po i jep Shqipërisë dhe shtetit shqiptar në demeko demokraci. Shtetit shqiptar të drejtuar në këto 30 vite nga Sali Berisha, Fatos Nano dhe Edi Rama. Një avokat politik që njeh pak sportin po thoshte se ne kemi 108 vite pa medalje. Kështu është kur nuk e njeh mirë as shtetin as kombin, sepse Ymer Pampuri ka si medalje të artë dhe rekord të përjetshëm olimpik. Kemi dhe kampionë bote në qitje dhe kemi rezultate tepër të larta në peshëngritje dhe atletikë, në rang european dhe botëror por...

Por vajzat e Kosovës, po japin leksion dhe nuk është kaq shumë meritë e qeverisë së Kosovës, e cila dhe po të dojë nuk ka se çfarë bën, por është mirësi dhe sukses i frymës së kombit shqiptar dhe shtetit të ri të Kosovës që i dalin individë që përjetojnë në gëzimin e tyre dhe të mirën që liria e Kosovës dhe Pavarësia e saj jep si kontribut. Nuk e di sa ka rënë sporti dhe arti në Kosovë nën ndikimin e politikës, por ajo që mund të them është se në Shqipëri

politika e ka shembur si sportin dhe artin nga korrupsioni dhe deliri antikombëtar dhe antikulturë e sport, që ishte dhe është në sundim në tre dekada. Nuk ka pse të ketë “smirë” për këto fitore të vajzave të Kosovës këtu në Shqipëri. Përkundrazi ne duhet të jemi krenarë dhe të lumtur pse vajzat e Kosovës me meritë marrin medalje të arta në Lojërat Olimpikë. Por ka dhe një diçka tjetër. Shoqëria shqiptare, duhet të kuptojë se kush janë rrënuesit e sportit shqiptar. Unë sigurisht ia di për faleminderit Edi Ramës për stadiumet dhe pallate sporti e ndonjë pistë që ka ndërtuar. Kjo duhet thënë dhe është turp mos ta thash por... Por Sali Berisha, Nano dhe Edi Rama janë përgjegjësit e shkatërrimit të sportit shqiptar si elitë dhe rëndësi kombëtare dhe shoqërore. Federatat tona dhe sidomos ajo e futbollit janë një marrëzi korruptive dhe një model publik shtetëror

binatit të korrupsionit dhe ministrive apo federatave të tilla, që mendojnë për katapultime si Rama me gratë e politikës dhe jo për meritën, e cila duhet të dalë në sajë të aftësive dhe jo në sajë të mendimit të individit sipër. Unë shpresoj që dhe Shqipëria të marrë një medalje apo dy, por nuk është ky thelbi i problemit. Thelbi është se shteti, kryeministri, ministrja përcjellin me flamur, por nuk kujdesen për elitën sportive në Shqipëri. Më vjen keq, por janë dobët, shumë dobët dhe në krahasim me regjimin kriminal të Enverit në këtë drejtim. Betejat dhe për federatat, janë politike dhe janë njerëzit e politikës që haptas i kanë bërë këto beteja. Janë beteja për paratë që shkojnë për gjithçka, por jo për cilësinë sportive. Kemi humbur masivitetin në shkolla dhe Rama e di këtë gjë. Nuk luajnë më fëmijët në shkolla dhe nuk bëjnë më orë fizikulture normalisht.

Shteti shqiptar ua ka lënë në dorë dhe pse paguan paratë klubet sportive – bashkive, të cilat janë fajtoret më kryesore për shëmtimin e artit dhe sportit. Sepse në Këshillat Bashkiake kanë futur idiotë partie si majtas dhe djathtas, të cilët nuk duan as sport, as art dhe kulturë. Duan vetëm perversitetet partie dhe fonde për pasurim politik dhe korruptivo-financiar. Patjetër që këto i di Rama por s’ka kohë. Shkurt fitoret e dy vajzave të Kosovës, janë meritë e shoqërisë kosovare që reziston. Që nuk varet shumë nga qeveritë, por bazohet te kombëtariteti i shoqërisë së sotme kosovare. Ato nuk shikojnë as eurot, as mundësitë e korrupsionit, por kanë synim medaljen e artë për veten dhe Kosovën. Shoqëria shqiptare është në “ceitnot” moral dhe politik e si pasojë dhe sportiv. Ajo nuk rebelohet dot përballë konkubinave politike dhe atyre televizive, që pa

meritë marrin fokusin dhe nuk rebelohet kundër demonëve të politikës dhe qeverisjes këto 30 vite që po e turpërojnë dhe llangosin përditë. Jemi një shtet lëtyrë që dhe Briken Calja kampioni european i joni, shkon në Olimpiadë dhe nuk i marrin trajnerin e tij. Ky është shteti dhe këto janë federatat tona. Janë federatat që kanë lejuar me anën e cinizmit dopingun dhe mos kontrollin në sportistë. Janë federatat dhe shteti sipër tyre, që nuk plotësojnë as kushtin moral dhe as kushtin stërvitor dhe as atë ekonomik për t’u përballur me botën. Për turp dhe faqe të zezë, politika shqiptare kryeministri, kryebashkiaku dhe opozita e korruptuar shqiptare përshëndesin vajzat e Kosovës sikur të ishte meritë e tyre. Po politika shqiptare, shteti shqiptar, ka një meritë që është shkatërrimi i sportit shqiptar, shkatërrimi i sportit elitë shqiptar si qitja dhe peshëngritja, apo më pak atletika dhe mundja. Të lumtë Kosovaaaaaaa! Ti i dhe leksion Shqipërisë në sport. Leksion shtetit të korruptuar dhe dekadent në Ballkan dhe sigurisht Europë këto 30-të vite. Shtetit të Berishës dhe Ramës e të gjithë të tjerëve që shkatërrojnë kulturën dhe sportin elitë e masiv. Sigurisht vajzat kosovare janë individë dhe pak ka të bëjë shteti Kosovës për këto fitore, as nuk është merita e tij, por fryma sportive dhe ajo kombëtare në sport është shumë më e madhe në shoqërinë motër kosovare dhe shtetin vëlla kosovar.



Nora Gjakova e Distria Krasniqi

i turpshëm. Përkujdesja për klubet dhe pagesat, janë një turp kombëtar. Ne kemi turp të paguajmë sportistë elitë të sporteve të vogla medalierë. Ne iu japim kredite “Përputhen” dhe marrëzive të tjera televizive si privat dhe shteti që është administruar nga Berisha, Nano pak vite dhe nga Rama, të cilët as që kanë bërë gjë për elitën sportive. Që ajo të qëndrojë në Shqipëri, që të mos bjerë në duart e konku-

Kollaj që ministrja e katapultuar të bëjë njeriun e sportit, kur orët e mësimit janë... bosh. Nuk ka ekupe shkollash dhe dëshirë për sport. Ka dëshirë për – obezitet si fizik dhe mendor. Largohen njerëzit e fundit të pasionit sepse zëvendësohen me konkubinave e partisë së portalizmit idiot, që merren o me letra kot si plotësim neveritës pa punë konkrete, o me fundet e shkurta që t’i pëlqejnë shumë pikërisht partisë.



# NË PËRVJETORIN E PARË TË DHAMË EDHE LAMTUMIREN E FUNDIT! PUSHOFESH NË PAQE I PAHARRUARI NDOC SELIMI!

Ende pa u harruar prezenca jote në kujtimet tona u mbush viti nga dita e largimit tënd, në të cilën nuk mundem as të të jepnim lamtumirën e fundit, si obligimi më njerëzor ndaj teje.

Për të gjithë njerëzimin 2020 -ta do të mbahet mend gjate si viti famëkeq i pandemisë botërore, por edhe i humbjeve të shumë jetëve njerëzore, ku shumë prej tyre lanë gjurmë të pashlyeshme si bashkëkohës, aq sa izolimi total për shkak të distancimit social të bën të mendosh se, ende gjenden në një cep të botës, duke punuar me atë vullnetin e hekurt, për të ndriçuar me diturinë e tyre realitetin njerëzor në koherencën e shekujve.

I tillë ishit edhe miku ynë i paharruari Piloti, studiuesi, poeti e humanisti, N/ kolonel Ndoc Selimi, largimi i të cilit u ngjante atyre ikjeve të herë pas hershme në shtetin fqinj, ku punove e jetove si qytetar model i asaj bashkësie edhe pse larg vendlindjes së tij, prej të cilave sado vone një ditë kthehej i mbushur me mall e me një mori projektsh në mendje e në duar për ta ndryshuar realitetin e këtushëm e sidomos atë të Komanit, vendlindjes së tij.

Por jo... e vërteta e mund imagjinatën, pasi me 21 gusht 2021 udhëtuam drejt Komanit të përmbushnim detyrën sublimë ndaj teje, ti shprehnim ngushëllimet familjes tënde. e cila kishte ardhur enkas nga Italia, me po atë dhimbje për largimin tënd pa kthim, e ty të të jepnim lamtumirën e fundit. Sikurse shkruante miku yt arkitekti Edi Belo, "një pjesë e jona mbeti bosh edhe pa ty nuk mbushet dot", as dhimbjet e kujtimet nuk mjaftojnë pasi mirësitë e veprave të tua kalojnë fuqinë e

njerëzve të zakonshëm dhe hyjnë në Saggat e Heronjve gogKomanas të Dinastisë tënde. Ishe një burim fisnikërie, dhembshurie, dashurie, ëmbëlsie, mençurie, i gjendur në çdo aspekt të jetës së të afërmeve të tu, miqve të tu, njerëzve në nevojë edhe veçanërisht të krahinës tënde Komanit, që sot pa ty ngjan e shkretë, e trishtë, e zymtë që nuk do ndjejë mbi të hapat e tua, prekjen tënde, shkrepjen e aparatit



tënd në thesaret e trashëgimisë edhe fjalët e tua që kumbonin aty. Sepse, pa ty projektet mbetën pa mbaruar, studimet pa

përfunduar, po pa ty ka humbje e drejta dhe e vërteta, ka humbje arti lirik poetik, ka humbje arkeologjia, ka humbje historia, ka humbje arti i pilotimit, ka humbje kultura Komane dhe Shqipëria një njeri të madh që i dha fuqi imazhit të saj në Botën shkencore edhe më shumë humbëm Ne miqtë e të afërmit e tu.

Ne ishim fare pak në një vjetorin tënd, por me vete kishim edhe mirënjohjen



e shumë miqve dhe dashamirësve të tu, të cilët në pamundësi për të ardhur na ngarkuan ne si përfaqësues të Shoqa-

tës Atdhetare "Dukagjini" ti përcillnim familjes tënde ngushëllimet më të sinqerta e të vendosnim tek varri jot një kurorë me lule në emër të shoqatës, tek e cila Ndoc Selimin zë një vend nderi e gëzon respekt tejet të veçantë.

Grupit tonë iu bashkua studiuesja dhe publicistja Rita Shkurtaj, e cila falë bashkëpunimit në disa punime me Maestron Ndoc Selimi siç e quan ajo, kishte fituar atë respektin e thellë ndaj tij, sa lamtumirën e saj e shoqëroi me lot e me lule të njoma tek i vendosi mbi varrin e tij.

Janë të pafundme fjalët dhe dedikimet ndaj teje, të cilat miqtë dhe të afërmit i thanë në shenjë respekti gruas tënde të mirë, znj. Prenë Selimi, djemve Ben dhe Elton Selimi dhe familjes tënde të shenjtë prej së cilës more dhe jetë!

Një moment shumë prekës ishte edhe momenti i dhurimit të librit "Kiri" të autorëve Prelë e Mri Kroj, nga z. Ndue Sanaj, në të cilin janë përfshi burime e referenca të marra së fundmi nga studiuesi Ndoc Selimi.

Me pejsazhin mistik të relievit morëm rrugën e kthimit të tretur në mallin dhe kujtimet që do mbeten të pa shlyera përgjithmonë në memorien tonë si visaret e atyre burimeve, të cilat me shumë krenari i shpjegonte gazetari dhe studiuesi vendas z. Zef Nika.

Lamtumirë maestro dhe miku ynë Ndoc Selimi!

Fjetje të paqte!

Do jesh gjithmonë në zemrat tona!

**Me respekt Redaksia e gazetës "Dukagjini", Gusht 2021**

## Tumori "i mirë" i mitrës?!

Kjo është një sëmundje jo e rrallë tek femrat e ashtu quajtur myoma si tumor "i mirë" i indit muskulat të mitrës, i cili ka varësi nga hormone femërore estrogenë. Është sëmundje e mirë, që karakterizohet me shfaqjen e tumorit mezenkimal i ndjeshëm ndaj hormoneve në muskulaturën e lëmuar të mitrës. Ky tumor nuk është një kancer (tumor malinj). Degjenerimi / transformimi nga myoma në një tumor të keq është shumë i rrallë vetëm 0,1-0.5% të rasteve. Fibromyoma shpesh është e mbështjellë nga një qese fibroze (pseudocapsule) që e ndan nga indit muskular i mitrës (myometri). Ngjason se fibromyoma të ketë një origjinë vërtetë njëqelizore (unicelulare). Pra, është monoklonale gjithë e cila shpjegon se myomat e ndryshme zhvillohen në vete uterusin dhe evulojnë në mënyra të ndryshme.

Dallojmë 3-lloje fibromash:

1-Fibroma brenda mukozës së mitrës, Intramukozale (e cipes së brendshme të mitrës)

2-Intramuskulare transmurale, brenda muskulit të mitrës

3-Subseroze (nen cipe e jashtme)

Origjina e vete fibromyomes fillon duke u nisur nga një qelize parësore, programi i secilës nuk pajtohet (është i

keqkuptuar). Por dihet se është e lidhur me një tepricë estrogenes (efekti mititik I tyre duket se favorizon ndarjen qelizore; gjithë e cila shoqërohet me një gabim të progesteronit ose një antagonistit të tij). Rivendosja jo normale e geneve është



shpesh në shumë kromozome të qelizave të fibromyomes. Ambienti i mitrës është shpesh me tepricë estrogenesh. Pra, hiperestrogenik ku gjendet nivel i lartë i estradiolit (E2), i estronit dhe sulfatit të tyre. Një hiperplazi është e shpesh në një fibromyomen submukoze dhe retesporet E2 janë më të shumte në numër në fibromyome sesa në muskulin normal të uterusit. Roli i progesteronit duket se është me kompleks. Ky hormon here-here duket se shpejton rritjen e myomes dhe ndonjëherë e ngadalëson. Kulturat qelizore të fibromyomes të ekspozuara me progesteron kane stimuluar aktivitetin myotik të myomes, e cila rritet në fazën luteale. Pësia e një fibromyome rritet kur ekspozohet ndaj një doze të madhe progesteronit në kohën që rritja zvogëlohet nga ekspozimi i fibromyomes ndaj analogeve gonadotropina (Gn-RH).

Receptoret e progesteronit (RcP) janë po ashtu më të shumte në numër në myomat ku zbulohet një mbi shprehje e ARNm-mesager (ARN.m) e progesteronit.

ARN-m për EGF është shumë e shprehur në fazën luteinike të myomes.

Një (add-back therapy) mund të ndaloj

vijon në faqen 15



# THETHI NJË THESAR I VËRTET I NATYRËS SHQIPTARE

**SYRI I KALTËR I THETHIT NJË PERLË E ALPEVE SHQIPTARE QË PO MAGJEPS NJERËZIT ZEMËRMIRË ME MAGJINË E TIJ**

Pak ditë më parë iu bashkova një grupi alpinistësh për të vizituar shumë të përfolur dhe reklamuar vizualisht Fshatin e Bukur të Thethit. Ishte vizita ime e parë dhe kurioziteti ishte maksimal për të përfutur çdo detaj apo veçori që e etiketojnë këtë fshat si një mister për turistët ambicioz vendas apo të huaj, të cilët sfidojnë çdo vështirësi udhëtimit dhe rendin vazhdimisht pas bukurive magjepse të natyrës.

Kisha dalë edhe herë të tjera në Qafë T'Thore (apo t'thore) që nënkupton pikjaden e thepisur të atij vendi dhe e dija se rruga ishte e përkryer deri në atë pikë, por së dija se punimi i rrugës deri në qendër të Thethit kishte avancuar aq shumë, sa të na mundësonte një udhëtim aq komod dhe të rehatshëm, megjithëse punimet vazhdonin akoma.

Për çudinë time çdo fushëpamje ishte krejt ndryshe nga sa e kisha imagjinuar, si një vend plot vështirësi jetese dhe banesa alpine të distancuara nga njëra - tjetra.

Me të mbërritur në qafën përballë kësaj lugine e deri në leqet e fundit të saj, gjatë gjithë atij segmenti rrugor, të shoqëronin tabela orientuese për prezencën e bujtinave apo toponime që diktonin vendndodhjen e tyre.

Diku në leqet e para më ra në sy një tabelë me mbishkrimin Çarku pranë një rrugice, e cila sipas shoqëruesit të guidës të orientonte tek Kulla e familjes së rapso-dit dhe kantautorit të shquar Nik Çarku, malësorit thethjanë që me dhuntinë e zërit dhe talentin e lidhur fort me dy telat e çiftelisë po bën epoke me karrierën e tij, duke lënë gjurmë edhe në etnokulturën shqiptare. Kullë e cila tashmë kishte hapur dyert për turistët si bujtinë, e që menaxhohej nga e talentuara pinjollë e kësaj familje, e mirënjohura si përfaqësuese në prezantimin e vlerave tona kulturore Gjyste Çarku Bici.

Një tjetër tabelë për të cilën edhe pyeta ishte ajo që të orientonte në Okolin e Thethit, një emërtim të cilin e ndeshim gjatë udhëtimit në pikën më të lartë të Bogës, ku sipas vendasve ky toponim nënkupton shullanin, apo pikën më të lartë të një territori.

Në Okolin e Thethit gjendej edhe kulla ku kishte lindur At Ambroz Martini, për të cilin kisha hulumtuar e që kisha kuriozitetin më të madh për ta vizituar, por që nuk arrita ta shoh nga afër pasi rruga në të cilën duhej të hynim ishte bllokuar nga makineritë e firmës ndërtesuese, të cilat në atë moment ishin në proces pune.

Mbërritja në qendër na mundësoi një panoramë magjepsëse 360° ku ne 3/4 e saj pamja ndalonte mbi malet e larta e të thepisura që binin pingul nga qielli dhe vetëm pjesa jugore të mundësonte një pamje horizontale tejet përrallore.

Ishte mëngjes dhe lokalet e bujtinave (të shumta në numër) sapo kishin hapur, gjë që të impononte një afat kohor pritjeje që

të shijojë gatimin tradicional të mëngjesit "petullat me mjaltë", jardunin apo gatimet e tjera të çastit. Pritje e cila të jepte kohën e mjaftueshme për të bërë foto apo shijuar në maksimum atë pejzash të bukur alpin nën shkëlqimin e rrezeve të para të diellit

E mahnitur nga ajo panoramë dhe kurioziteti për të mësuar sa më shumë nga misteret e këtij vendbanimi të etiketuar dekadat e fundit edhe si pikë turistike me nxiste të pyesja vazhdimisht mbi artefaktet, traditat, gojëdhënat, ku mbresat më të veçanta m'i la Kulla e At. Danjel Gjeçaj me



artefaktet e skalitura mbi muret e saj.

Tek shijonim mëngjesin e shkëmbenim bisedën e këndshme me të zotin e bujtinës ku qëndruam, më mbeti në mendje një shprehje shumë më filozofike se ato që të ofrojnë librat "ZOTI I TË ZOTIT TË SHTËPISË ËSHTË EDHE MË ZOT SE ZOTI I MIKUT" për të cilin përbehen (zënë be) miku dhe i zoti i shtëpisë, çka nënkuptonte pagesën e mëngjesit në favor të mikpritjes dhe respektit të mikut.

Me shijen e mirë të atij mëngjesi u larguam për të vizituar Kishën e Shën Gjonit të Thethit që po ri konstruktohej nga artizanët vendas, të cilët kujdeseshin të ruanin deri në detaje arkitekturën e saj origjinale. Një objekt kulti modest me krehje tipike alpine, por që mbart mbi vete gjur-



më të shumta historike dhe ngjarshë të përmendura në shumë relacione kishtarë, të cilat e identifikojnë atë si monument kulture të rëndësishme së parë.

Tek soditnim me sy të lirë atë bukuri të lashtë natyrore, dikush nga grupi hodhi idenë për të vizituar Syrin e Kaltër, pasi ndihej i mahnitur nga fotot që kishte parë në internet, të cilat na i tregoi nga telefoni i tij.

Mjaftoi kaq që guida të marri një kthesë tashmë të planifikuar drejt atij destinacioni ku fillimisht morëm info mbi rrugën,

parkimin si dhe porositem ushqimin nëpërmjet numrit të kontaktit që bujtina aty pranë kishte shpërndarë në internet.

Sipas shpjegimit të vendasve për të shkuar në destinacion kishe dy mundësi rrugëtimi dhe me që ne kishim makinë tip 4x4, falë edhe pakimit të prurjeve hidrografike, si dhe për të shkurtuar rrugë kaluam Lumin e Shalës fare pranë Kullës së Ngujimit, pranë së cilës pamë shumë turistë dhe vizitor, të cilët bënë foto dhe film-onin pasazhin që u përftohej nga ajo kodër.

Për hire të vërtetës rruga për në Kaprre ku gjendej Syri i Kaltër ishte shumë e dëmtuar nga erozioni, aq sa gërryerjet që kishte pësuar e bënë atë gati të pamundur për makinat e ulta, megjithatë ne e shijuam duke marrë me sy çdo shpat mali



mbi të cilat kishin skalitur gjurmët e tyre ortekët e borës dhe shenat apo rrjedhat e ujit gjatë dimrit.

Për sigurinë tonë makinën e parkuam në oborrin e bujtinës së fundit ku mbaronte rruga e makinës, e cila gjendej diku rreth 1 km larg, e ku pjesën tjetër të udhëtimit duhej ta bënim me këmbë.

Do e quaja një udhëtim modest për një pjesë të grupit që merreshin me aktivitete fizike në përditshmërinë e tyre, por aspak të tillë për ata që u ngjitën për herë të parë e që në jetën e përditshme bënin një jetë sedentare dhe pa shumë lëvizje, megjithatë udhëtimi ishte shumë i këndshëm, pasi gjatë gjithë rrugës takojë turistë nga e gjithë bota, aq sa mund të themi se Syrin e Kaltër në Thethë e përshëndetnin të gjitha gjuhët e botës.

Megjithëse ishte një terren i vështirë ku shumë segmente të asaj rruge të bënin të sfidoje edhe fobitë nga lartësitë, pasi rruga e kalit apo e këmbësorëve, e cila gjurmonte prej shekujsh në atë itinerar malor të impononte të kaloje fare pranë kanjoneve që binin pingul rreth 500 m poshtë këmbëve të tua dhe përsëri kjo gjë nuk i pengonte turistët dhe pushuesit ta bënin shpesh këtë udhëtim, madje as të moshuarit dhe fëmijët.

Sapo i afroheshe destinacionit ndjeje rrymat e freskëta të ajrit të cilat i çlironte uji i rrjedhshëm i borës, gjë që të mbushte me oksigjenin e pasur me biodiversitetin e kësaj natyre të egër alpeze, sa ta ndjeje veten sikur gjendesh në një botë krejt tjetër, sidomos kur para syve të shfaqej Syri i Kaltër i Thethit.

I parë nga afër Syri i Kaltër i Thethit ishte një mrekulli më vete dhe ajo që e bënte edhe më të veçante këtë sy ishte uji i akullt që buronte nga një e çarë shkëmbi. Sipas vendasve kush guxonte të notonte në të, testonte shëndetin e zemrës dhe diagnostikohesh me zemër të mirë që nënkuptonte shëndetin e plote të këtij organi jetik. Madje edhe po të hyje qofte edhe vetëm me këmbë në atë ujë, ata e vlerësonin si një kurë shumë efektive për qarkullimin e gjakut, si dhe rregullimin e pulsit të zemrës, çka bënte që ky sy të thirrej ndryshe "Doktori i Zemrës".

Në sofrat e improvizuara mbi bokat e krijuara nga gërryerja e dherave përballë Syrit të Kaltër e nën rrezatimin e ylbërës që përthyej mbi sipërfaqen e ujit magjik, shijuam ushqimin e shijshëm me gatime të zonës.

U larguam duke marrë me vete kënaqësi të pafundme nga ai vend, me dëshirën e mirë për t'u kthyer sërish.

Udhëtimin në Theth mund ta quaj një nga eksperiencat më sfiduese të kësaj vere, por edhe më të vlefshmit për të kuptuar sa e lidhur është jeta jonë me natyrën.



# ZEF MURI - ARTISTI SHUMDIMENSIONAL

Dukagjini ka nxjerrë figura të shquara në të gjitha fushat e jetës, si në ato historike, ashtu edhe në shumë fusha të tjera, si poet e shkrimtar, aktor e këngëtar, sportist e ushtarak dhe në art e kulturë, duke bërë emër në të gjithë Shqipërinë, me të cilët krenohet Dukagjini e Shkodra. Edhe sot ka shumë dukagjinat të suksesshëm në arte të ndryshme, sport, kulturë e në të tjera fusha, të cilët po ja ngrejë akoma më lart emrin e Dukagjinit. Një ndër ta është edhe Zef Muri nga fshati Gurrë e krahinës së Shoshit, një artist shumë dimensional, shumë i suksesshëm në pikturë e skulpturë, i cili është objekt i këtij shkrimi.

U lind 72 vjet më parë në një familje me emër shumë të mirë në Shosh e Du-

kagjin. Shkollën fillore e bëri në Ndrejaj, kurse 7 vjeçaren në Palaj – Shosh. Bënte diferencën ndër moshatarët e tij për zgjuarsi, i cili njihje vetëm notën 5 (notë maksimale për kohën). Na çudiste me cilësinë e vizatimeve që i kalonin përmasat e moshës- shprehet ish mësuesi i tij, veteran i arsimit dukagjinat, z. Mirash Ndrejaj. Pra, pikturën e kishte një dhunti të lindur. Kushtet ekonomike të kohës nuk ja mundësuan që të vazhdojnë shkollën e mesme apo të lartën në të cilat me siguri që do të shkëlqente. Në moshë të re mori rrugët për t'i ardhur në ndihmë ekonomike familjes, duke punuar në veprat hidroenergetike: 1971-1977 në hidrocentralin e Fierzës dhe 1984-86 në Koman,



në të dy veprat si piktor dekori e dizajno. Aty shpërthej talenti i Tij. Ju dha mundësia që të bëj një kurs 2 vjeçar për piktor dekori dhe pastaj punoj për shumë vite në sektorin e edukimit, ku ranë në sy aftësitë e tij, me cilësinë e punës që bënte në pikturë e dizajne. Ju dha mundësia që të kenë kontakte me piktorët e skulptorët më në zë të kohës, të cilët krahas vlerësimeve maksimale për punën që bënte i dhanë edhe ndihmesën e tyre me këshilla dhe bazë materiale. Sipas Zefit ndihmesën më të madhe ja ka dhënë inxhinieri Fuat Dushku, një personalitet i njohur për kohën si drejtues institucionesh të artit e kulturës në Tiranë, i ardhur 2 vjet në Fierzë, të cilit i dedikon një pjesë

vijon nga faqja 13

rritjen e fibromyomes. Një agjent anti-progesteron (p.sh 25mg/dite), ose pilula ulipristol acetat (esemya ) 5mg redukton volumin e fibromyomes.

Faktorët hormonal të rritjes duket se marrin pjese në këtë proces: EGF (epidermal growth faktor) invitro stimulon prodhimin e ADN-s nga qelizat e muskulit uterin (myomatoze) dhe PGDF (platelet derivate growth faktor) dhe YGI, te tre këto hormone janë në mënyrë anormale shumë aktiv të pranishëm në leyo-myome. Hormone I rritjes po ashtu mendohet se është pjesëmarrës.

Në më pak se 10% të rasteve ka një faktor predispozues familjar, ka mundësi për origjinë gjenetike, por nuk është bere akoma e mundur të gjendet marker gjenetik specifik.

Në gjithë rastet e tjera të shkaqeve ambientale e rrethanore ose mikrobiale do të jete i mundur c' rregullimi hormonal, endokrin (distilben ). Në të gjitha rastet një faktor i dyfishtë hormonal (parakrin dhe autokrin), duket se është në loje.

Çështja e ndikimit të një agjenti mutagen (transformues), endogjen ose – dhe ekzogjen mundet të mbi vendoset në fibromyome, ashtu si dhe në tumoret e tjera mezonkimale. Por dhe mutacione të rëndësishme gjenetike somatike, që do të thotë se nuk lidhen me prindërit, janë vërejtur sidomos në kromozomet 1, 6, 7, 12, 13, 14, 19.

Facto rreziku janë të shumëfishtë të evidentuar nga ana epidemiologjike, që me sa duket konfirmojnë origjinën e varur nga estrogenet ose implikohet një ose shumë faktor turbullues endokrin:

Mosha (30-45 vjeç, periudha e premenopauzes)

Faktor etnik sidomos brrunet.

Nulipariteti (mos lindja e fëmijëve)

Fillimi i hershem i menarkeve (periuda e para) .

Përdorimi i DIU me bakër (aparateve implantuese kundër shtatzënisë)

Ekziston gjithashtu një faktor gjenetik i mundshëm.

Prevalenca një studim sistematik mbi një kampion të gjere është vlerësuar se mosha mbi 75-vjec, 70% e grave të bardha (kaukaziane) dhe 80% e grave me ngjyre kane fibromyome uterine. Në përgjithësi në 60-70% të rasteve janë pa

shenja dhe nuk justifikohen me shenja për tu marr nen kujdes shëndetësor.

Shenjat klinike:

Mund të jene plotësisht pa shenja dhe zbulohet vetëm kur behet ekzaminim sistematike, ose imazherik / ekografik. Simptomat janë të ndryshme dhe varen nga lloji i këtij tumori. Në përgjithësi shenjat mund të jene: hemorragji uterine(methroragi, ciklike ose jashtë periodave, e cila në fibromyomat submukoze (të cipes së brendshme te mitrës) ka një mungese periodash prej 9-10 javësh, mund të kemi shtim të sasisë dhe zgjatjes kohore të periodave. Kjo hemorragji vjen nga vaskularizimi (qarkullimi) i shtuar i gjakut në vendin e tumorit. Gjaku ka kuagula (pirgje). Kjo hemorragji është më e madhe natën, gjë e cila e detyron të ndryshohen shpesh kompresat higjienikë. Anemia, e cila është rrjedhojë direkte e menometroalgjis (trjedhjes e gjakut me menstruacione apo jashtë ciklit) kemi ulje të numrit të rruazave të kuqe, renje e nivelit të hemoglobines dhe ulje të homatokritit.

Shenjat kompresive, veçanërisht tek fibromyomat e cipes së brendshme (submukoze) jep shqetësim ose dhimbje pelvike, urinim të shpeshtë, djegie dhe kapsllëk. Këto shenja shfaqen kur fibromyoma ka dimensione të mëdha. Infertiliteti (mos lindja) fibromyoma vepron si një trup i huaj, arsye të ndryshme mund të shpjegojnë këtë fenomen si: një rritje e tkurrjes se mitrës, një kongestion venoz (fryrje e enëve venoze), prishja e muskularizimit të myometrit (muskulit të mitrës) dhe e endometrit (cipes së brendshme), me cilësi jo të mira. Prania e fibromyomes mund të shpjegoj uljen e fertilitetit vetëm në 3% të rasteve (veçanërisht ne fibromyomat e mëdha), të cilat zvogëlojnë hapësirën dhe deformatojnë uterusin. Lodhja: sidomos pas periudhës së periodave, për shkak të hemorragjisë më të madhe, që çon në anemi (ulje te rruazave te kuqe dhe të hemoglobines). Në raste të veçanta ka dhimbje të forte akute, shqetësime domethënëse si në rastin e torsionit (përdredhjes ) së një fibromyomes me pedunkul (me bisht) veçanërisht në formën subseroze.

Si përparon fibromyoma dhe ndërlikimet e saj?!

Për sa i takon madhësisë fibromyoma rritet me kalimin e kohës, në përgjithësi me afro 35% në vit. Ndërlikimet e saj

janë: nekrobioza (kalbëzimi i qendrës se tumorit) ndërlikim i cili prek fibromyomat voluminoze mbi 10cm diametër, po ashtu mund të ketë dhe hemorragji. Siç u përmend, mund të ndodh dhe përdredhja e fibromyomes me pedunkul, e cila mund të çoj nganjëherë në ndërlikime serioze me hemorragji dramatike, që përben një urgjence madhore gjinekologjike meqë se kjo hemorragji është masive dhe e padalueshme dhe kërkon ndërhyrje të menjëhershme operatore.

Si vendoset diagnoza?

Me ane të anamnezës, dhe ekzaminimeve klinike dhe suplementare, me palpacion mund të preket mase ose rritje e volumit të mitrës, por duket të kemi parasysh se, dhe një uterus normal nuk përjashton fibromyomat. Ajo, që vërteton diagnozën është ECHO pelvike ose endovaginale deri në TAC dhe RMNI, mund të vizualizojnë dhe fibromyomat e vogla.

TRAJTIMI:

Për sa i takon trajtimit marrja në kujdes është esenciale për fibromyomen qofte për një arsye apo një tjetër si: infertiliteti (shterpësi) hemorragjia e madhe, dhimbje pelvike, lumbare ose dhimbje barku rruaduese.

Menaxhimi i fibromyomes, pavarësisht madhësisë së saj, kur nuk ka shenja duhet të mbahet një qëndrim pritës, duke bere ekzaminime 1-2 here në vit , ECHO pelvike, ose ekzaminime imazherike të tjera sipas rastit. Qëndrimi pritës mbahet po ashtu në veçanti tek grat nulipare (qe nuk kane lindur). Në raste kur fibrimyoma ka shenja përveç masës sipas madhësisë, por dhe hemorragji ose ka nyje të shumta (fibromyome multinodale), duhet të planëzohet kirurgjia.

Mjekimi me ilaçe, rritja e fibromyomes është në varësi të hormoneve progesteron dhe estrogen. Antagonistet e gonadotropina (GnRH si levonogestrel) bën që të ulet përkohësisht volume i fibromyomes, por ky efekt nuk qëndron pas ndërprerjes së mjekimit, dhe nga ana tjetër ka dhe efekte anësore gjate mjekimit. Ulja e rrezikut tek gratë, që marrin pilula (KOK) është i diskutueshëm?! Shoqata Amerikane e Mjekësisë Riproduuese nuk rekomandon përdorimin e as të KOK e as të progesteronit (depo-provero) modeluesit selektiv (përzgjedhës) të receptorëve të progesteronit (SPRMS), me baze ultiprestal-acetal

(miferpriston RU 436) ose ellone, esmia) indikohet që prej vitit 2012, për të marre në kujdes fibromyomen. Në fakt këto induktojnë ndalimin e hemorragjisë në më pak se tre dite, ul madhësi dhe volumin e fibromyomes pas një kohe të gjate përdorimi, eviton here-here dhe ndërhyrjen kirurgjikale duke përmirësuar cilësinë e jetës të pacientes. Ky trajtim me baze ulipristol-acetat ose miferpristol tolerohet në përgjithësi mire dhe mund të jepet për kohe të gjate derisa të ulet volume i fibromyomes. Ky ilaç vepron në mënyrë specifike mbi fibromen duke induktuar vdekjen e qelizave tomurale.

Trajtimi kirurgjikal është fjala për shkakun e pare të histeroektomis (heqja e mitrës) ku në SHBA kryhen 300 mije ndërhyrje në vit, për këtë shkak me një kosto mbi 2mln dollar. Në këtë rast kemi dy variante, histeroektomin totale dhe heqjen pjesore d.m.th. heqjen vetëm të fibromyomes, kjo e fundit kryhet tek gratë, që nuk kane lindur dhe që dëshirojnë të kenë fëmijë në të ardhmen. Por duhet të kemi parasysh që heqja e plote e mitrës është mjekimi përfundimtar në mënyrë që të mos krijohet një fibromyome tjetër. Në saj të trajtimit para operacionit me ulipristol ose miferpristol kirurgjia është më e thjeshte nga që volume dhe numri i fibromyomave pakësohet dhe hemorragjia është më e pakte dhe kohe e operacionit më e shkurtër. Sot, në shumë vende të zhvilluara po përdoret edhe embolizimi arterial, si alternative e operacionit, e cila kryhet me ane të kateterizimit, duke u udhëhequr nga imazheria (angiografi RMN), me ane të një mikro-kateteri që arrin në arterien uterine, e cila ushqen tumorin, teknike, e cila ka filluar që në vitin 1997 dhe në vitin 2008 është realizuar në 1100 raste (pra është një terapi e përzgjedhur dhe e vlerësuar si më me pak ndërlikime së histeroektomia).

Jeni të lutura të gjitha femrat, që kane një myome të mos e lini pas dore, të bëjnë një ndjekje 1-2 here në vit nga obsteter-gjenkologu dhe të mos neglizhojnë këshillat e dhëna për ekzaminim e trajtim, sepse çdo shmangie është në disfavor të shëndetit tuaj.

Përgatiti: dr. med Ndue Nikaj



◀ të suksesit. Zefi vlerëson edhe ndihmën që i ka dhënë piktori i talentuari Ferdinand Paci. Në Fierzë apo kudo që ka punuar, mbas orarit të punës ishte shumë i dhënë mbas peizazheve, portreteve e grafikeve, relieveve e basorelieveve. Peizazhet e tij janë botuar në shumë gazeta e revista të kohës. Me peizazhin “Katarakti i Thethit” ka zënë vend të parë në një konkurs kombëtar.

Mbasi pikturën e bëri profesion deri në perfeksion, ju përkushtua skulpturës, ku edhe në këtë degë të artit u bë shumë i suksesshëm dhe vazhdon të jetë i tillë. Me daltë e çekiç ka gdhend në gurë e dru skulptura të llojeve e përmasave të ndryshme, sipas kërkesave, duke filluar që nga Gjergj Kastrioti-Skënderbeu mbi kalë, Nënë Terezën, Edith Durham e deri kafshë të të gjitha llojeve, duke filluar që nga shqiponja, kali dhe të gjitha kafshët e pyllit të kërkuara nga njerëz të ndryshëm për zbukurimin e ambienteve familjare. Skulpturat e dal nga dora i tij janë të vendosura në shumë ambiente publike e private: si ato të Edith Durham e të amerikanes Rosa Lej me shoqëruesen e saj të vendosura në pikën turistike të Thethit, busti i malësorës i vendosur në Bardhaj, engjëj dhe shenjtër të ndryshëm të vendosur në kisha, shtëpi, muze e galeri të ndryshme. Tek Zefi gjen zbatim në mënyrë perfektë shprehja: “Ç’ i sheh syri ja bën dora”.

Zefi, ishte dhe është shumë profesionist dhe i aftë edhe në disiplinën e pirografisë, me djegie në dru, duke bërë figura të ndryshme si dhe akuarel me bojëra. Me forcat e veta ka bërë aparat pirografik për djegie. Shumë i arritshëm në relieve e basorelieve në dru apo portrete të ndryshme të ekspozuara pranë familjeve të ndryshme sipas porosive të tyre. Është shumë i suksesshëm në ndërtimin e mozaikëve me gurë lumi me ngjyra natyrale. Ka hedhë në mozaik shumë figura të shquara si Nënë Tereza apo edhe kafshë të ndryshme si kali e të tjera, si dhe peizazhe të ndryshëm. Me gdhendje në gurë dhe dru ka bërë dhe bën ibrikë të madhësive e llojeve të ndryshme, si dhe shumë enë kuzhine si dikur motit, pjata, bluda, lugë të madhësive të ndryshme e të tjera. Është specializuar në bërjen e të gjitha veglave muzikore tradicionale: si lahutën, çiftelinë, zumaren, duke i zbukuruar ato me figura të ndryshme, me gdhendje, djegie apo pikturë siç është Gjergj Kastrioti-Skënderbeu në kokën e lahutës. Talentin e tij e shkrin në hedhjen në letër, sidomos bardhezi, të figurave të ndryshme historike të para daljes së fotografisë si të Zek Jakinit, apo portrete të njerëzve të vjetër, duke fut në punë fantazinë mbi bazën e të dhënave dhe përshkrimeve që të afërmit e tyre japin. Për të tilla portrete ka pasur shumë kërkesa të cilat të gjitha i ka plotësuar, ku Zefi është i vetmi momentalisht në këtë degë arti. Punimet e tij në pikturë



e skulpturë janë blerë dhe vendosur edhe në shtete të ndryshme të botës: si në jug të Francës, Itali, Amerikë dhe kudo ku flitet shqip. Në shumë vende ka bërë zbu-



kurime çezmash, burimesh dhe shatërvanësh me gurë të gdhendur të llojeve e madhësive të ndryshme. Shquhet në bërjen e dyerve prej druri me gdhendje të formave të ndryshme ku kërkesat i ka pasur të shumta, duke pas për bazë cilësinë e tyre.

Për punën e tij është vlerësuar nga institucione të ndryshme shtetërore dhe sot, por jo sa ka merituar. Vlerësimin më të madh ja ka dhënë Shoqata Atdhetare “Dukagjini” me titullin “Mirënjohja e Shoqatës Atdhetare Dukagjini”, për kontributin e dhënë në fushën e artit, si dhe me titullin “100 vjet arsim e kulturë në Dukagjin” dhe Certifikatën “Peneli i Dukagjinit”, si dhe është fitues i stemës “Guri i Zi”. Për punën e bërë dhe që po bën, Zef Muri meriton vlerësimin më të lartë nga strukturat shtetërore qendrore.



Ambientet e jashtme dhe të brendshme të shtëpisë së tij modeste ngajjnë më një galeri arti me punimet e artistit Muri të disiplinave të ndryshme, ku dominojnë skulpturat e llojeve të ndryshme në gurë dhe dru.

Zef Muri nuk është vetëm një artist i suksesshëm shumëdimensional, por edhe një prind shembullor. Me bashkëshorten Roza lindën, rritën dhe edukuan dy djem të mrekullueshëm, Kelerin dhe Kristjanin, të cilët janë duke ecur me hapa të shpejtë në gjurmët e të atit. Keleri shumë i pasionuar dhe i talentuar në skulpturë e gdhendje, kurse Kristjani në pikturë. Të tre së bashku kanë krijuar një kantier artistik, ku përditë janë në punë dalta, çekiçi, peneli, vajrat e të tjerë.

Zoti Muri nuk është vetëm artist, por mbi të gjitha është NJERI. Është fjalëpakë e punë shumë. E karakterizon thjeshtësia dhe sjellja e kulturuar, merret me punën e vet e jo çfarë bëjnë të tjerët. Ruan me fanatizëm vetitë e virtytet më të mira të mbartura nga vendlindja, të cilat i qëndrojnë kohës, duke i harmonizuar me normat e reja qytetare të ambientit të ri të banimit. Është shumë i komunikueshëm. Me punën e sjelljen e tij ka fituar respektin e banorëve të mjedisit ku punon e jeton, si dhe të gjithë atyre që e njohin anë e mbanë vendit. Moshë nuk e pengon për t’u ulur për asnjë çast ritmin e punës. Ka në proces shumë vepra arti siç është busti i Prekë Calit në gurë me përmasa 1.6 m i gjatë.

Është e pamundur me e paraqit të plotë në një shkrim punën dhe veprimtarinë e Zef Murit, por shpresojmë që në të ardhmen do të paraqitet më gjerë, pse jo edhe nga një monografi apo dokumentar.

Zotëri Zef Muri i urojmë jetë të gjatë, shëndet të plotë dhe një prodhimtari artistike sa më cilësore e sasiore në interes të familjes dhe të atyre që kanë nevojë për veprat e tij.

**Prele SHYTANI,**  
gusht 2021

**REDAKSIA**

**Kryeredaktore: LUIGJ SHYTI**

**Prelë Milani, Lazer Stani, Roza Pjetri, Lazer Kodra, Zef Nika, Zef Gjeta, Lulash Brigja, Age Martini, Klodjana Serraj, Vilsan Peshkaj, Marjan Ndershtiqaj, Arber Shytani, Zef Bari, Gjon Fierza, Ndue Ziçi, Gazper Marku, Mark Gjeka.**

**Mundësoi Botimin:  
Fran Shytani**

